

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7338 E hënë 30 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga BELIND KËLLIÇI

Shtatorja e Azemit i tremb bijtë e etërve



Vendosjen e shtatorës së Azemit në qytetin e tij të lindjes, në Bajram Curri kisha ditë që e prisja me një gëzim të brendshëm, nga ato gëzimet që, në fakt, është...
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga SHABAN MURATI



Shqetësimi amerikan për modelin serb të "dy karrigeve"

S'HBIA ndërmorën një hap të fortë diplomatik ndaj Beogradit, duke i drejtuar mesazhin diplomatik dhe publik se Serbia nuk mund të vazhdojë më lojën e dyfishtë...
Vijon në faqen 21



Kryeministri: Shumë shpejt do të kemi rezultatet e vetingut

Integrimi, Rama: lu luta opozitës, por më akuzuan, s'kanë ide për të ofruar

Reagon kreu i PD-së: Sa e do drejtësinë, e tregoi skandali "Tahiri"

Nga DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama konfirmoi dje se shumë shpejt komisionet e vetingut do të japin rezultatet e para të punës, ndërsa akuzoi opozitën se nuk po del mbi interesat e pushtetit për të bashkëpunuar për interesat madhore të vendit. Në rubrikën e tij të...
Në faqet 2-3

INTERVISTA/ DREJTORESHA E SHERBIMIT SOCIAL SHTETËTOR: PAGESAT PER ÇDO KATEGORI

"NDIHMJA EKONOMIKE, SI MUND TA PERFITONI"

Luneda Sufali: Nga familjet pa të ardhura, jetimët te viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, të gjitha kategoritë që përfshihen në skemë



(Në foto) Luneda Sufali, drejtore e Përgjithshme e ShSh. Foto ilustruese



Në faqet 6-7

KRYETARJA E LSI-SË

"Ish-ministra e bashkëpunëtorë të Ramës do shkojnë para drejtësisë"

Në faqen 3

MONITORUESIT EVROPIANE

"Droga në 2016: Në Shqipëri kanabisi kultivohet në toka me pronësi shtetërore"

Në faqen 4

PROJEKTLIGJI

Reforma në drejtësi, si ndryshojnë tarifat e çështjeve gjyqësore e kush përjashtohet

Në faqen 5

MESAZHET PREKESE

Shuhet në moshë të re gazetaria Adela Xhamani, ëndrrat që la pas

Në faqen 10

KESHILLAT E MJEKES



Infeksionet urinare, Kategoritë më të prekura, çfarë duhet të konsumoni

Suplement

INTERVISTA/ Ngarja në një shkollë të Sarandës, 17-vjeçari: Të merren masa

E plagosi shoku, Bodini: Ndodhi prej bullizmit

"E ngacmonim, por nuk e prisja që debati do degradonte deri në këtë pikë"

Nga INA ALLKANJARI

Nuk e prisja që një zënkë e vogël të degradonte në plagosje me thikë, për më tepër brenda ambienteve të shkollës. Që në 9-vjeçare shokët e klasës e ngacmonin, menjëherë debati shkoi deri në këtë pikë prej bullizmit".



Kostandin Bodini, 17-vjeçari që u plagosi me thikë nga bashkëmoshatari

Kështu është shprehur dje për "Gazeta Shqiptare" 17-vjeçari Kostandin Bodini, pas sherrit të ndodhur disa ditë më parë në ambientet e shkollës së mesme profesionale, "Antonia Athanas", në Sarandë. 17-vjeçari, i cili u plagosi me thikë nga shoku...
Në faqen 8

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kreu i PD-së akuzon kryeministrin për vetëvrasjet e qytetarëve

Basha: Rama dhunon e burgos të varfrit dhe ndihmon kriminelët

"Sa e do drejtësinë, e tregoi skandali 'Tahiri'"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha akuzoi sërish dje kryeministrin Edi Rama se nuk e do drejtësinë, pasi këtë e tregoi edhe çështja "Tahiri". Në një postim në rrjetin social, "Facebook", Basha u shpreh dje: "Se sa e do Rama drejtësinë, e tregoi skandali 'Tahiri', se me kë bashkëqeveris Rama e treguan përgjimet e antimafias italiane". Kontributi i Edi Ramës për drejtësinë është sulmi ndaj prokurorëve, ndaj dëshmitarëve, policëve të ndershëm e madje edhe ndaj gazetarëve, siç bëri pasi plasi skandali Tahiri". "Ndaj me paturpësi, përpjekjen e opozitës dhe gjithë shoqërisë për të çliruar politikën nga Sajmir Tahirit e drogës, nga ministrat që fikin radarët e ushtrisë dhe nga policët që ngarkojnë thasët e drogës, e quajti sot një grindje të vogël", vijoi më tej, kreu i PD-së. Sipas tij, "Drejtësia që Sajmir Tahiri dhe Edi Rama u ka dhënë shqiptarëve janë njerëzit e ndershëm, njerëzit e varfër që janë rrëmbyer në kundërshtim me ligjin për akuzat qesharake. Kriminelët janë nxjerrë nga burgju, janë bërë deputetë dhe kryetarë bashkie, drejtorë dhe "biznesmenë". "Edi Rama dhe shteti mafioz që ai drejton e arrestoi dhe e çoi në vetëvrasje 22-vjeçarin Estref Halili nga Kolonja e Lushnjës për një cigare hashash. Për Tahirin, që është kapur në përgjimet e antimafias me tonelata hashash nuk ka arrest, por mbrojtje politike me imunitet", risolli në vëmendje, Basha. "Melita Çenga, infermiere nga Shkodra, Brunilda Meka nga Korça u hoqën nga puna dhe shkuan drejt vetëvrasjes se nuk mbanin dot familjen. Tahiri që në përgjimet e antimafias del se merrte 30 mijë euro vetëm për një ngarkesë, breddi i lirë, sepse e mbron Edi Rama. Resmijë Alla, 35 vjeç humbi jetën duke rridhur korrentin për pompën e frymës së djalit të saj 6 vjeç me astmë, se nuk kishte



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

Deklarata

ENKELEJD ALIBEAJ

Pas deklaratës së kreu të grupit të PS-së, deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj tha: "Para dy ditësh Edi Rama gënjeu publikisht se Zaganit është i dënur nga Krimeve e Rënda". Ai shtoi se "Deri më sot nuk ka asnjë vendim gjyqësor për fajësinë e Zaganit. Se masa e sigurimit 'Arrest në burg' e kërkuar në vitin 2014 pranë Krimeve të Rënda është një tullumbace e shfrytëzuar, nga vetë kjo gjykatë për mungesë provash".

mundësi të paguante faturën e rritur. Tahiri merr 9 mijë euro byzylykë, 15 mijë euro diamante nga trafikantët, mban syze 10 mijë euro, por për Edi Ramën këto janë letra bakalli", janë këto rastet që denoncoi kreu i PD-së, Lulzim Basha. Më tej ai vijoi me emra të tjerë. "Qamil Zela, i burgosur, i vetëvarur për një borxh prej 3 mijë e 200 lekësh ndaj OSHEE, Arif Doda, Klajdi Muça, Llazar Nasi, Gjovalin Gjini, e dhjetëra të tjerë, i ka çuar Edi Rama drejt vetëvrasjes për faturën e energjisë, por për

ministrin e tij të Brendshëm me targë AA003GB që bënte trafik droge, nuk ka prova. Sepse atij "nuk i mjaftojnë 20 milionë euro për fushatë" siç shprehën bashkëqeverisësit Habilaj në përgjimet e antimafias", - nënvizoi Basha. Kreu i PD-së, tha se "Edi Rama dhe qeveria e tij janë të zhytur në krim dhe të kapur nga krimi. Shteti mafioz që burgos dhe dhunon të varfrit dhe mbron e ndihmon kriminelët dhe politikanët e lidhur me krimin duhet shembur nga themelet".

MASA E ARRESTIT

Arresti ndaj Zaganit u bë pasi më 2 maj 2014 gjyqtarja Flora Hajredinaj kishte caktuar ndaj tij masën e sigurisë në mungesë arrest me burg për shpërdorim detyre e moskallëzim krimi, masë kjo e kërkuar nga prokurori Anton Martini. Por, kjo masë arresti me burg ndaj Zaganit u shua pasi më 8 nëntor 2014 Gjykata e Krimeve të Rënda caktoi ndaj tij masën e sigurisë arrest në shtëpië.



AKUZA

Kreu i PD-së, tha se "Edi Rama dhe qeveria e tij janë të zhytur në krim dhe të kapur nga krimi. Shteti mafioz që burgos dhe dhunon të varfrit dhe mbron e ndihmon kriminelët dhe politikanët e lidhur me krimin duhet shembur nga themelet".

Partia Socialiste publikon vendimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda

Balla: Për Zaganin, arrest me burg, Basha mbron të arrestuarin

PS e PD u përplasën dje, për ish-oficerin e policisë së Fierit, një nga akuzuesit e ish-ministrit Sajmir Tahiri, Dritan Zaganin. Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla tha dje, se kreu i opozitës, Lulzim Basha gënjeu në lidhje me dënimin e Dritan Zaganit. Sipas Ballës, Krimeve e Rënda kanë dhënë masën e arrestit me burg ndaj Zaganit nën akuzën e dekonspirimit. Po ashtu, PS publikoi edhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda që ka caktuar arrestin e Zaganit për Dritan Zaganin në maj të 2014. "Për Dritan Zaganin Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë masën arrest me burg, bazuar mbi kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda që në hetimin e saj ka konstatuar krimin e dekonspirimit (për llogari të një grupi trafikantësh) të një operacioni antitrafik të Policisë së Shtetit. Pas vendosjes së kësaj mase sigurie, Dritan Zaganin është zh-



Taulant Balla



Vendimi i gjykatës për Zaganin

dukur për t'i ikur drejtësisë dhe është shfaqur më pas nga jashtë vendit, si heroi mediatik i Partisë Demokratike", - sqaroi Balla. Edhe pas reagimit të kreu të PD-së, mbrëmjen e djeshme, Balla u shpreh: "E ftoj miqësisht Lulzim Bashën dhe Partinë Demokratike të heqë dorë nga heroi i tyre mediatik Dritan Zaganin. Nuk mundet që partia kryesore e opozitës të ketë hero një të dënur me vendim të formës së prerë "Në emër të Republikës" me 3 vite burgim". Duke publikuar vendimin e gjykatës, Balla shtoi: "Nuk pres që Lulzim Basha dhe as PD të kërkojë ndjesë. Sepse, siç thashë në mëngjes, të gënjejë është e

vetmja punë që Lulzim Basha di të bëjë më mirë. Por të betohesh për drejtësi mbi fjalët e një personi të arrestuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda që në hetimin e saj ka konstatuar krimin e dekonspirimit (për llogari të një grupi trafikantësh) të një operacioni antitrafik të Policisë së Shtetit dhe më pas i dënur nga gjykata për largim nga vendi i qëndrimit të detyruar, kjo nuk është vetëm qesharake, por është shembulli më i qartë ku ka degraduar "vizioni" i PD për drejtësinë", tha Balla.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi dje, se çdo ditë që afron tregon fundin e kësaj qeverisje të dështuar. Në një reagim të saj, pas "Komunikimit javor" të Edi Ramës, kryetarja e LSI-së shkroi në "FB": "Kryeministri i frikësuar edhe sot aktroi duke "qarë" hallet e popullit e duke përgëzuar procesin e vetingut. Edi Rama flet për drejtësinë, ndërkohë që nuk lejon prokurorinë të hetojë për ish-bashkëpunëtorin e tij të ngushtë. Përhëndet komisionet e vetingut dhe nga ana tjetër përçmon dhe fyen ato institucione që faktotj përfshirjen e ish-ministrit të Brendshëm në trafikun e drogës". "Edi Rama në dukje i pa shqetësuar aktron me shpresën se do t'i shpëtojë drejtësisë. Duke harruar se faktet dhe

Kryetarja e LSI-së: Kjo qeveri e dështuar po shkon drejt fundit

Kryemadhi: Ish-ministra e bashkëpunëtorë të Ramës do shkojnë para drejtësisë



provat shumë shpejt do të çojnë në bankën e të akuzuarve ish-ministra dhe bashkëpunëtorë të afërt të tij. Proces, nga i cili as ai vetë nuk do të shpëtojë. Dhe për këtë nuk e ndihmon dot

as fasada e përditshme që u ofron shqiptarëve nga ERTV apo media të tjera që i kanë nën kontroll, as sharjet ndaj opozitës madje as provat gjenerale të pyetje-përgjigjeve para prokuror-

it",-u shpreh Kryemadhi. Sipas saj, "Njerëzit e thjeshtë po vuajnë pasojat e fuqizimit të oligarkisë dhe mjerimit të ekonomisë së familjes. Vuajnë pasojat e papunësisë varfëruese e të pamundësisë për të ndërtuar një jetë më të mirë për veten apo fëmijët". "Përballë padrejtësisë të qeverisë, guximi i shqiptarëve do jetë më i fortë se forca e pushtetit arrogant. Çdo ditë që kalon shënon afrimin drejt fundit të një qeverisje të dështuar që do mbahet mend për kanabizimin e Shqipërisë dhe inkriminimin e politikës. Vendi duhet të kthehet në shërbim të qytetarëve",-tha kryetarja e LSI-së.

Kryeministri: Komisionet e vetingut shumë shpejt do na tregojnë rezultatet e para konkrete

Integrimi, Rama: lu luta Bashës, por më mallkoi

"Ata që drejtojnë opozitën, nuk kanë as vizion e as ide për të ofruar"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama konfirmoi dje, se shumë shpejt komisionet e vetingut do të japin rezultatet e para të punës, ndërsa akuzoi opozitën se nuk po del mbi interesat e pushtetit për të bashkëpunuar për interesat madhore të vendit. Në rubrikën e tij të përjavshme "Komunikimi javor", kryeministri Rama u shpreh: "Dua t'ju siguroj që pavarësisht zhurmës së pazakonshme dhe pengesave të ngritura qëllimisht gjatë këtyre ditëve jo vetëm që s'e kam harruar, por as e kemi lënë për asnjë moment pas dore punën për të cilën jemi zgjedhur". "Javën që u mbyll Komisioni Europian e vlerësoi në një raport të vetin Shqipërinë për rritjen më të shpejtë ekonomike në rajon, për konsolidimin e financave publike dhe për uljen e borxhit publik. Banka e Shqipërisë, nga ana e saj, ka vlerësuar që indeksi i besimit të operatorëve ekonomik, ndërmarrjeve dhe konsumatorit është rritur mbi nivelin mesatar të 10 viteve të fundit. Të dhënat e eksporteve kanë shënuar rritje shumë inkurajuese në dy shifra, në 10 për qind në bazë vjetore. Ka vijuar po ashtu



Kryeministri Edi Rama

rritja e importit, makinerive dhe pajisjeve, çka tregon se po vazhdojnë investimet prodhuese, të cilat sjellin dhe punësim real",-u shpreh kryeministri. Sipas tij, "Edhe në luftën kundër informalitetit gjatë muajit tetor është konstatuar rritje e xhiros në 24 % dhe e kuponëve të lëshuar me 23 %. Të gjitha këto janë lajme të mira që natyrisht më motivojnë edhe më shumë, por pa dyshim nuk na mjaftojnë aspak. Kemi ende kaq shumë për të bërë në drejtim të investimeve, në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, bujqësi e turizëm, e po ashtu me luftën me krimin dhe korrupsionin sa nuk ka asnjë sekondë kohë

për të humbur me grindje e llafe politike". "Në 4 vjet nga sot Shqipëria duhet të jetë shumë më afër Bashkimit Europian se sa është sot dhe është dhe do të jetë përgjegjësia ime, një përgjegjësi që nuk më tremb, përkundrazi më nxit që të bëj çdo ditë më shumë jo vetëm, por bashkë me gjithë të tjerët. Më bën të mendoj se si do minutë të përdorim për ta arritur këtë qëllim të madh kombëtar në rrugën e Shqipërisë që duam",-u shpreh Kreu i qeverisë. **OPOZITA** "I kam lutur kundërshtarët tanë për një pakt për të punuar së bashku për këtë qëllim dhe për disa ob-

jektiva me interes kombëtar. Si përgjigje kam marrë mallkime pa hesap dhe akuzat pa kufij, Të cilat tregojnë se ata që drejtojnë sot opozitën, jo vetëm që nuk kanë vizion dhe as ide të rëndësishme për t'i ofruar Shqipërisë, por fatkeqësisht nuk kanë as forcën morale për ta vënë Shqipërinë mbi interesat e tyre të vajtueshme. Keqardhje e thellë për ta",-u shpreh Rama, duke akuzuar opozitën. "Ne e kemi marrë të plotë përgjegjësinë për të udhëhequr Shqipërinë dhe për të bërë gjënë e duhur për njerëzit e këtij vendi dhe do ta mbajmë këtë përgjegjësi me të gjithë nderin dhe përkushtimin që na takon",-

shtoi ai. "Por,- vijoi më tej kryeministri- njëkohësisht duam që sa më shumë njerëz të zakonshëm të marrin përgjegjësinë e tyre duke u bërë pjesë e koalicionit tonë me ta në rrugën drejt Europës për Shqipërinë që duam". "Në këtë rrugë të së ardhmes nuk ka ne dhe ju, nuk ka qeveri lart dhe njerëz poshtë, por bashkëqeverisje me njerëzit si të barabartë mes të barabartëve",-tha Rama. "Edhe komisionet e vetingut tanimë janë ulur në zyrat e tyre dhe kam bindjen se shumë shpejt do na tregojnë rezultatet e para konkrete të besimit dhe të mbështetjes popullore që kanë marrë",-njoftoi ai. Sipas kryeministrit, "Ky është një tjetër hap i madh, një hap përpara në rrugën tonë për BE dhe për Shqipërinë që duam me shtet, punë e mirëqenie. Dhe siç qëndruam të vendosur së bashku dhe zbrapsëm çdo orvatje për ta vrrarë reformën në drejtësi bashkë me vetingun për dy vjet me radhë, po ashtu do të mbështesim me të gjithë energjinë patriotike, politike, e morale jetësimin e aspiratës kombëtare dhe popullore për drejtësi në këtë vend. Asnjë hap s'do jetë i lehtë, por ndjenja e përgjegjësisë ndaj vendit dhe ndaj njerëzve që na besuan është kaq e madhe sa që asgjë nuk do na ndalojë dot",-tha kryeministri.

Petrit Vasili:
Rama, si "Beni ecën vetë" këndon këngë nga frika
 Petrit Vasili Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh dje, se "Kryeministri flet në frikë, si Beni që këndonte këngë partizane në pyll. Ky shkollëpaku llogotit e grin fjalë, që nuk i kupton, lart e poshtë dhe gjithë ditën, në konferenca facebookiste, në parlament, kur u hakërrehet gazetarëve, kur flet për ekonominë imagjinare, nga e cila s'kupton hijçgje, kur shkreh njërën budalallëk pas tjetrit, kur i lemerisur voton kundër drejtësisë për të mbrojtur drogën dhe trafikantët, kur i trembur për vdekje bën be që nuk ka frikë". "Mos humbni hiç kohë që ta dëgjoni gjithë këtë logore halucimante të tij, sepse a e dini pse e bën? Do t'i japë kurajë vetes shkollëpaku i trembur shumë, ashtu si Beni i vogël të filmi, që nga frika këndonte këngë partizane kur ecte në pyll",-shkroi dje, në "FB", Vasili.

RAPORTI DROGA

Zbardhet raporti i Qendrës Monitoruese Evropiane, dokumenti konfidencial

Droga në 2016: Në Shqipëri kanabisi kultivohet në toka me pronësi shtetërore

"Trafikantët bashkëpunojnë me prodhuesit shqiptarë"

Shqipëria renditet si një prej vendeve me prodhimin më të madh të kanabisit në Europë. Këtë konstatim i ka bërë Qendra Monitoruese Evropiane në raportin e saj sekret për drogën në vitin 2016. Sipas raportit, publikuar nga ABC News dokumentet konfidenciale ishin dërguar më parë në zyrat e Ministrisë së Brendshme, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror. Në raportin e Qendrës Monitoruese Evropiane, të dërguar institucioneve tona nga shërbimet sekrete italiane, Shqipëria renditet si një prej vendeve me prodhimin më të madh të kanabisit në Europë. Dokumentet konfidenciale theksojnë se, në shumicën e rasteve trafikantët ndërkombëtarë të drogës bashkëpunojnë me prodhuesit shqiptarë. Çdo vit europianët shpenzojnë rreth 24 miliardë euro për lëndët narkotike, thuhet në raport. Partnerët italianë theksojnë se kjo shifër është mjaft shqetësuese, duke kërkuar që të merren masa sa më shpejt të jetë e mundur për të paralizuar rrjetin e narkotrafikut me origjinë nga Shqipëria. Një tjetër shqetësim që shprehet në raportin e Qendrës Monitoruese Evropiane për 2016 është edhe kultivimi i kanabisit në zonat e jugut të vendit tonë. Raporti i 2016 thekson se Guarda di Financa, së bashku me Ministrinë e Brendshme përdorën avionët për të fotografuar plantacionet me drogë, por që nuk rezultoi efikas në terren. Në fund raporti problematik për Shqipërinë evidenton se kultivimi i drogës kryhet në toka me pronësi shtetërore, në tunele, sera ose magazina. Ky raport i përket vitit të kaluar, ndërsa në 2017 Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi edhe arrestimin e ministrit të Brendshëm të asaj kohe, Saimir Tahiri. Sipas organit të akuzës ka dyshime se ai ka favorizuar grupin kriminal të vëllezërve Habibaj, të kryente trafik drogë gjatë periudhës 2013-2017. Ndërkohë vetëm pak ditë më

Qendra Monitoruese Evropiane: Shqipëria një prej prodhuesve kryesorë të kanabisit

Shqipëria vijon të mbetet një prej prodhuesve kryesorë të kanabisit në Europë, pavarësisht operacioneve për shkatërrimin e dhjetëra hektarëve të mbjellura me bimë narkotike në Lazarat gjatë verës së vitit 2014.

Në dokumentin e lëshuar nga kjo Qendër për ne theksohet se situata mund të ketë ndryshuar disi me operacionet e kryera, por Shqipëria, së bashku me Serbinë, Bullgarinë dhe Kosovën, mbeten një prodhues masiv i kanabisit. Destinacionet më kryesore të tregimit të kësaj lënde narkotike janë Greqia, Italia, Holanda, Hungaria, Republika Çeke si dhe Austria. Megjithatë, theksohet se kanabisi shqiptar tregtohet në një sasi të konsiderueshme edhe në Francë e në Gjermani.

Raporti komunikon se trafikantët më të mëdhenj të kanabisit në Europë janë ata marokenë të cilët garantojnë transportin si dhe shifjen në tregjet e kontinentit të vjetër. Raporti komunikon se në shumicën e rasteve, këta trafikantë bashkëpunojnë me prodhuesit shqiptarë.

Në tema të përgjithshme, raporti gjykon se europianët shpenzojnë çdo vit 24 miliardë euro për lëndët narkotike. Zyrarët kanë gjykuar se kjo shifër nevojshme që të merren masa sa më shpejt të jetë e mundur për të paralizuar rrjetin e narkotrafikut me origjinë nga Shqipëria.

Faksimile e raportit të Qendrës Monitoruese Evropiane

SHIFRAT

Çdo vit europianët shpenzojnë rreth 24 miliardë euro për lëndët narkotike, thuhet në raport. Partnerët italianë theksojnë se kjo shifër është mjaft shqetësuese, duke kërkuar që të merren masa sa më shpejt të jetë e mundur për të paralizuar rrjetin e narkotrafikut me origjinë nga Shqipëria.



Foto ilustruese

Guardia di Finanza

Raporti i 2016 thekson se Guardia di Finanza së bashku me ministrinë e Brendshme përdorën avionët për të fotografuar plantacionet me drogë, por që nuk rezultoi efikas në terren. Në fund raporti problematik për Shqipërinë evidenton se kultivimi i drogës kryhet në toka me pronësi shtetërore, në tunele, sera ose magazina.

Kreu i PBDNJ: Kryeministri, problemi me Greqinë

Kanabizimi, Dule: Rama ka vënë në rrezik imazhin e vendit

Kreu i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Vangel Dule në ceremoninë e përvitshme pranë varrezave greke në fshatin Boboshticës të Korrçës, tha dje, se marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe grekëve janë në nivel më të lartë, por problemi sipas tij është kryeministri Edi Rama. "Duhet të jemi të qetë dhe krenarë për marrëdhëniet që kemi ngritur në boshtin e tyre me 2 popujve. Janë marrëdhënie në nivelin më të lartë. Nëse ka një problem midis vendit tonë dhe Greqisë fatqësisht ai është vetëm kryeministri i vendit Edi Rama, i cili nuk i shërben axhendës tradicionale të marrëdhënies midis dy vendeve, por kërkun të imponojë një axhendë që është në diskordancë të plotë me ndjenjat dhe dëshirat e



popullit shqiptar", - u shpreh dje, Dule. Sipas tij, kjo axhendë "i shërben vetëm agjendës personale dhe ambicisë së zotit Rama. Kur popujt kanë gjetur zgjidhjen, nuk ka lidhshp që mund të dalë mbi të. Është një parantezë e zotit Rama

më hijet e tij. Kalimtare do të jetë". I pyetur për akuzat ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, Dule u shprehet se ato janë vetëm maja e ajsbergut. "Jemi duke parë vetëm majën e ajsbergut. Kanabizimi i vendit që e denoncomim edhe me disa kolegë të tjerë është përtej asaj që edhe ne mendonim se mund të ishte. Me sa duket ishte një projekt kultivimi masiv dhe intensiv dhe kjo nuk mund të bëhet me përgjegjësinë e një ministri. Kjo ka përgjegjësi kryesor politik moral vetë kryeministrit Rama, i cili ka vënë në rrezik jo vetëm imazhin ndërkombëtar të vendit, por edhe shoqërinë, familjen e individin. E vetmja rrugë mbetet katarsisi i plotë i të gjitha sferave dhe vetëm ai mund ta çlirojë vendin", -tha Dule.



Ministri i Brendshëm Marco Minniti

Ministri i Brendshëm italian të enjten në Tiranë, takon Xhafajn

Ministri i Brendshëm i Italisë, Marco Minniti, pritet të mbërrijë ditën e enjte më 2 nëntor në Tiranë. Ai do të zhvillojë një vizitë zyrtare pune ku do të takohet me homologun shqiptar, Fatmir Xhafaj. Dy ministrit janë takuar pak ditë më parë më 24 tetor në Trieste në samitin rajonal mes ministrave e krerëve të policisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor. Italia drejton një projekt të rëndësishëm evropian "Ipa-Polizia 2013 Balcani Ocidentali", që ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërrajonal në luftë kundër kimit të organizuar, trafiqeve ilegale, sigurisë ndërkombëtare e luftës kundër terrorizmit. Vizita e ministrit italian Marco Minniti sjell një interes të veçantë mediatic për shkak të zhvillimeve të fundit politike në vend, rrjedhë e shkatërrimit të një bande të strukturuar italo-shqiptare e hipotezës së përfshirjes në të, të ish-ministrit të Brendshëm italian Saimir Tahiri.

parë, autoritetet italiane kanë ngritur shqetësimin për trafikun e drogës që është sekuestruar ditë e fundit. Prokurori i Përgjithshëm i Antimafias italiane Franko Roberti në një dalje publike

është shprehur javën që shkoi ndaj situatës së trafikut të drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Ai tha se më mirë do të ishte të legalizoheshin drogat e lehta, duke i dhënë një goditje të rëndë

klaneve të narkotrafikut. Prokurori i ka bërë thirrje parlamentit dhe qeverisë italiane që të gjejnë një zgjidhje për këtë shqetësim. "I kemi kërkuar parlamentit dhe qeverisë italiane

që të gjendet një zgjidhje. Ose të bashkojmë të gjitha forcat për të luftuar trafikun e drogave të lehta, ose t'i japim shtetit monopolin e prodhimit e shitjes së drogave të lehta, duke njohur

mungesën e vlerës morale të përdoruesit të saj. Objektivi i shtetit është të luftojë fuqitë kriminale dhe jo të bashkëtojë me ta.", -pohi prokurori, shkruajnë mediat italiane.



Projektligji në Kuvend, padi për divorcin kushton 5 mijë lekë

Reforma në drejtësi, si ndryshojnë tarifatat e çështjeve gjyqësore

Cilat janë kategoritë që përjashtohen nga pagesat

Darina Tanushi

Komisioni parlamentar i Ligjeve miratoi javën e shkuar projektligjin për tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore. Sipas relacionit të paraqitur, bashkëngjitur ligjit që do të miratohet edhe në seancën plenare, "Duke qenë se sistemi i tarifave gjyqësore aktuale nuk reflekton shpenzimet për funksionimin e sistemit të gjykatave dhe taksapaguesit ngarkohen me barrën e mbajtjes së këtij shërbimi, ky ligj ka për synim kalimin, për sa të jetë e mundur, të kësaj barre, fillimisht, te palët ndërgjyqësore, të cilët inicijojnë procesin gjyqësor". Në të njëjtën kohë, me qëllimin që t'i jepet e vëmendje individëve, të cilët kërkojnë drejtësi, por që nuk mund të përballojnë tarifata gjyqësore të larta, kategori të caktuara gjykimi ose shërbimi janë të përjashtuara nga tarifatat gjyqësore ose kanë vlerë të pranueshme. Tarifatat e përgjithshme aplikohen para fillimit të çështjes dhe mbi këtë bazë nis gjykimi. Ato përlloragiten mbi bazën e vlerës së çështjes. Ky nen është elementi thelbësor i sistemit të ri shqiptar për tarifatat gjyqësore. Për gjykimin e kërkesave civile, administrative dhe penale është parashikuar një tarifë fikse prej 2.500 (dymijepesëqind) lekësh. Ndërkohë një tarifë fikse prej 5.000 (pesëmijë) lekësh është parashikuar edhe për: gjykimet e ankimeve të veçanta, ankimit kundër një vendimi penal në gjykatën e apelit, paraqitjen e rekursit kundër një vendimi penal në Gjykatën e Lartë, për çështjet penale me të dëmtuar akuzues; ndërkohë që ankimi për këto të fundit do të ketë si tarifë fikse shumën prej 2.500 lekësh. Tarifatat janë përcaktuar me qëllim ruajtjen e ekuilibrit mes të ardhurave mesatare minimale të Shqipërisë nga një anë dhe sigurimit të drejtës për akses në drejtësi nga ana tjetër. Risi janë parashikuar në pikat 3-6 të nenit 4, ku parashikohet se paditësi është ai që përcakton vlerën e padisë dhe, nëse kjo përlloragitje nuk është paraqitur në padi, gjykata e kthen



Ndryshohet data, shenjtërimi i Nënë Terezës, 5 shtatori ditë feste, jo 19 tetori

Kuvendi pritet të ndryshojë me një projektligj të veçantë datën e festës zyrtare të shenjtërimin të Nënë Terezës. Ndryshimi në projektligjin synon vendosjen si festë zyrtare datën 5 shtator - Dita e Shenjtërimin të Shenjtë Terezës dhe heqjen si festë zyrtare datën 19 tetor - Dita e Lumturimit të Nënë Terezës, duke qenë se Dita e Shenjtërimin është një ditë me e rëndësishme nga pikëpamja fetare. Projektligji nr.7651, datë 21.12.1992, "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar; është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i qeverisë shqiptare. Kështu përcaktohet si festë zyrtare data 5 shtator Dita e Shenjtërimin të Shenjtë Terezës, duke qenë se nga pikëpamja fetare Dita e Shenjtërimin është më e rëndësishme se Dita e Lumturimit. Projektligji është hartuar nga Ministria e Kulturës, me kërkesën e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

padinë për plotësim (pikat 3,4); në rastet e padive për mbrojtjen e të drejtave të pronarëve vlera e padisë përkon me vlerën e sendit (pika 5); vlera e padisë me objekt detyrime kontraktore mujore, gjashtëmujore, vjetore do të jetë ekuivalente i pagesës që duhet shlyer për 12 muaj. Vlera minimale e tarifës për çështjet administrative është 700 lekë me tavan vlerë padie deri në 700.000 lekë. Palët ndërgjyqësore mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin për ndihmën juridike. Çdo organ publik shtetëror që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër.

Çmimet
Nëse qytetarët do të duan të hapin një çështje administrative, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, një padi do të kushtojë 5 mijë lekë të rinj. Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit do të kushtojë 2500 lekë të rinj dhe po kaq do të kushtojë rekursi në Gjykatën e Lartë. Një padi për zgjidhje të martesës tani do të kushtojë 5 mijë lekë të rinj.



Buxheti faktik 2016 nis diskutimi në Kuvend, shoqërohet nga raporti i KLSH

Buxheti faktik 2016 nis sot, diskutimin në komisionet parlamentare. Ky projektligj pritet të shoqërohet edhe nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit "Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2016". Sipas relacionit, ky projektligj përmban të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit (qeverisjes qendrore), të buxhetit vendor, të buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), të buxhetit të Fondit Special të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe të buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave (AKKP). Gjithashtu përmban të dhëna mbi deficitin e përgjithshëm të qeverisjes së përgjithshme dhe burimet e financimit të tij (të brendshme nga huamarrja e qeverisjes qendrore dhe vendore, privatizimi dhe të tjera; të jashtme, duke përfshirë edhe mbështetjen buxhetore). Ky draft shoqërohet me: 1.Raport për situatën makroekonomike dhe buxhetore për vitin 2016, me anën e të cilit bëhet një analizë e detajuar e treguesve kryesorë makroekonomikë dhe e realizimit të treguesve buxhetorë për vitin 2016. Raporti përmban, gjithashtu, të dhëna statistikore, informacione dhe një bashkësi treguesish, të cilët janë në funksion të një gjykimi sa më racional, mbi rezultatet dhe treguesit kryesorë të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme për vitin 2016; 2.Një raport mbi borxhin shtetëror dhe operacionet e tjera të lidhura me borxhin dhe shërbimet e tij gjatë vitit 2016; 3.Një raport mbi përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës së buxhetit të shtetit; 4.Informacion për kontrollin e brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

TARIFAT E REJA TE PROCESEVE GJYQESORE	
Tarifata e përgjithshme në gjykatat administrative	
1. Shkalla e parë	Vlera
Padi për:	5.000 lekë
> shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;	
> për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;	
> për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;	
> për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;	
> për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasojë juridike, nëse paditësi ka një interes të zryshëm për këtë;	
> për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik;	
> për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;	
> për përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar kur është rasti dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jokompetent;	
Paditë për shpërblimin e dëmtuarit kontraktor dhe jashtë kontraktor, si dhe paditë për marrëdhëniet e punës janë sipas tarifave të përgjithshme të gjykimet e këtyre çështjeve nga gjykata civile për çdo shkallë gjykimi.	
2. Gjykata e Apelit Administrativ	Vlera
Ankimi kundër vendimeve të gjykatave të shkallëve të para	2.500 lekë
Ankimi i veçantë	2.500 lekë
Në rastet kur gjykata e administrative e apelit ka juridiksion fillestar, tarifa do të jetë e njëjtë me atë që aplikohet përgjykimin në shkallë të parë	
3. Gjykata e Lartë	Vlera
Rekursi në Gjykatën e Lartë për gjykimet administrative	2.500 lekë
Kërkesë për pezullim ekzekutim të vendimit	2.500 lekë
Përjashtimet nga Neni 4 sipas objektivit të padisë	Vlera
1. Padi për pension ushqimor	Pa pagesë
2. Padi me objekt marrëdhënie pune, kur vlera e padisë është deri në 700.000 lekë. Mbi këtë vlerë tarifa e përgjithshme do të jetë sipas parashikimeve për tarifën e përgjithshme gjyqësore të cilën në nenin 4 të këtij ligji	700 lekë
3. Padi për zgjidhje martesë	5.000 lekë
4. Padi për pjesëmarrje pasurie bashkëshortore	5.000 lekë
5. Padi të tjera sipas Kodit të Familjes	5.000 lekë

NDIHMA EKONOMIKE KATEGORITE

Shërbimi Social Shtetëror: Përfshihen dhe gratë e prekura nga dhuna në familje

Sufali: Cilat janë kategoritë që përfitojnë ndihmë ekonomike

"Pagesa jo më shumë se 8000 lekë në muaj"

Voltiza Duro

Plot 80401 familje në vendin tonë përfitojnë ndihmë nga Shërbimi Social Shtetëror për shkak të situatës të vështirë ekonomike. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Drejtoresha e Përgjithshme e këtij institucioni, Luneda Sufali tregon të gjitha kategoritë që përfitojnë ndihmë sociale e shërbime të kujdesit shoqëror nga ShSSH. Gjithashtu, ajo bën me dije se rreth 67 mijë persona në Shqipëri marrin një masë të caktuar pagese për shkak se janë deklaruar si të paafetë për punë, e po ashtu marrin ndihmë edhe kujdestarët e tyre. Drejtoresha thekson se ndihma ekonomike është e përcaktuar me VKM e llogaritet sipas strukturës së familjes, por masa maksimale e plotë e kësaj ndihme për familjen nuk mund të jetë më e lartë se 8000 lekë të reja në muaj. Që prej qershorit të vitit 2014 drejt Shërbimit Social Shtetëror janë dërguar rreth 100 mijë kërkesa nga 12 qarqe për të përfituar ndihmë ekonomike. Ky institucion, ndërkaq merret edhe me programimin dhe detajimin e fondeve për shërbimet shoqërore, pagesat e personave me aftësi të kufizuara dhe ndihmën ekonomike.

Cfarë është Shërbimi Social Shtetëror dhe çfarë ofron?

Shërbimi Social Shtetëror është institucion varësie i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Misioni i tij është zbatimi e politikave të mbrojtjes sociale përmes vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, kontrollit për zbatimin e legjislacionit për përfitim të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, SHSSH ofron edhe akomodimin në institucionet rezidenciale të individëve në nevojë.

Cilat janë kategoritë që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shoqëror që ofron ShSSH?



Drejtoresha e Përgjithshme e ShSSH, Luneda Sufali

Kategoritë në nevojë që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shoqëror që ofron

ShSSH janë fëmijët në nevojë, të moshuarit e braktisur dhe pa të ardhura, per-

sonat me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeç. Gjithashtu, prej shërbimeve tona përfitojnë edhe personat që kanë rënë pre e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe individët apo familjet në situatë emergjence.

Për cilat kategori ofrohet ndihmë ekonomike?

Ndihma ekonomike nga Shërbimi Social Shtetëror ofrohet për këto kategori: familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; jetimët, të cilët nuk janë në institucione; prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre; viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes. Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë Kategoritë që përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror: Fëmijë në nevojë Të moshuar të braktisur dhe pa të ardhura Persona me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeç Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore Viktima të dhunës në familje Individë dhe familje në situatë emergjence

KATEGORITË QË PËRFITOJNË NDIHMË EKONOMIKE:

- ➔ Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- ➔ Jetimët, të cilët nuk janë në institucione;
- ➔ Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- ➔ Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- ➔ Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes.
- ➔ Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë
- ➔ Kategoritë që përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror:
- ➔ Fëmijë në nevojë
- ➔ Të moshuar të braktisur dhe pa të ardhura
- ➔ Persona me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeç
- ➔ Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore
- ➔ Viktima të dhunës në familje
- ➔ Individë dhe familje në situatë emergjence



timit të Aftësisë për Punë. Sipas vendimit të komisionit mjekësor përfitojnë pagesa personat, të cilëve u është kufizuar aftësia fizike, shqisore, e intelektualit, psikike apo mendore të lindura apo

të fituara nga sëmundje, që nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

A ofroni trajtime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara?

Disa prej llojeve të shërbimeve që u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara janë shërbime terapeutike dhe edukative për rritjen e aftësive konjiktive. Gjithashtu, institucionet përkatëse, që janë nën varësinë tonë ofrojnë edhe terapi okupacionale, logopedi, fizioterapi e aktivitete socializimi dhe kulturore. Në varësi të nevojave që kanë personat me aftësi të kufizuara, ofrojmë edhe plotësimin e nevojave shëndetësore, shërbim mbështetës zhvillimi dhe ndihmë për integrimin e kësaj kategorie në shoqëri. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara deri në 21 vjeç ofrohen në 8 qendra zhvillimi publike, 2 me shërbim ditor dhe 6 rezidenciale, të cilat financohen nga buxheti qendror; 6 prej tyre janë në administrim të bashkive. 2 qendra zhvillimi janë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror të vendosura në Tiranë dhe Durrës.

Cilat janë kriteret për të përfituar ndihmën?

Risia e skemës së re të ndihmës ekonomike, ndryshe nga skema e vjetër, nuk ka kriteret përjashtuese për individët dhe familjet që duan të përfitojnë këtë pagesë. Të gjithë mund të aplikojnë dhe më pas sistemi elektronik bën verifikimet me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me ➔

Disa prej llojeve të shërbimeve që u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara janë shërbime terapeutike dhe edukative për rritjen e aftësive konjiktive. Gjithashtu, institucionet përkatëse, që janë nën varësinë tonë ofrojnë edhe terapi okupacionale, logopedi, fizioterapi e aktivitete socializimi dhe kulturore.



SKEMA

Risia e skemës se re të ndihmës ekonomike, ndryshe nga skema e vjetër, nuk ka kritere përjashtuese për individët dhe familjet që duan të përfitojnë këtë pagesë. Të gjithë mund të aplikojnë dhe më pas sistemi elektronik bën verifikimet me të gjitha institucionet dhe pasi përfundon ky verifikim në lidhje me saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje.

← saktësinë e informacionit merret vendimi për këto familje.

Sa është numri i personave që marrin ndihmë ekonomike sipas kategorive të caktuara?

Plot 80401 familje përfitojnë ndihmë nga ky institucion për shkak të situatës ekonomike. Ndërkaq përfitojnë ndihmë edhe 375 fëmijë trinjakë, 24 katërnjakë, 5 pesanjakë dhe 564 jetimë. Gjithashtu, rezultojnë 198 viktime dhunë në familje që marrin ndihmë nga SHSSH, 9 viktime trafikimi, 238 fëmijë me familje kujdestare, dhe 14 fëmijë me aftësi të kufizuara në familje kujdestare.

Sa persona përfitojnë pagesë për shkak të paaftësisë në punë?

Në të gjithë vendin 67069 individë me aftësi të kufizuara marrin një pagesë mujore

pasi janë të paaftë për punë dhe krahas kësaj ndihmë ofrohet edhe për 18668 kujdestarë e personave me aftësi të kufizuara.

Sa varion pagesa e ndihmës ekonomike sipas kategorive përkatëse?

Masa e ndihmës ekonomike është e përcaktuar me VKM dhe llogaritet sipas strukturës së familjes dhe masa maksimale e plotë e ndihmës ekonomike për

“
Numri i aplikimeve për përfitimin e ndihmës ekonomike në 3 qarqet, në të cilën zbatohet sistemi elektronik i ndihmës ekonomike që nga qershori 2014 është 31.000 familje apo individë aplikues. Ndërsa në 9 qarqet e tjera numri i aplikuesve është 64.000 familje apo individë aplikues.

të 3000 lekë në një muaj, për viktimat e trafikimit 3000 lekë, për viktimat e dhunës po 3000 lekë në muaj. Ndërkohë, të gjithë fëmijët e vendosur në shërbim kujdestarie marrin ndihmën ekonomike prej 9000 lekë në muaj, shtuar këtu edhe 25000 lekë në vit për fëmijët që ndjekin shkollën. Më tej pagesa ekonomike për fëmijët me aftësi të kufizuara, të vendosur në kujdestari është



Foto ilustruese

familjen nuk mund të jetë më e lartë se 8000 lekë të reja në muaj. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh është: për trinjakë, 3000 lekë për çdo fëmijë; për katërnjakë, 4000 lekë për çdo fëmijë; për pesnjakë, 5000 lekë për çdo fëmijë. Ndërsa për kategoritë e veçanta masa e ndihmës ekonomike për jetimet është

të 10000 lekë në muaj.
Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët për të përfituar ndihmë?

Në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan aplikohet sistemi elektronik për përfitimin e ndihmës ekonomike. Për të përfituar ndihmë ekonomike me skemën e re, kryefamiljari së bashku me bashkëshorten nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten

TE DHENA

Masa e ndihmës ekonomike, në muaj për kategoritë e veçanta:

- ➔ për jetimet 3000 lekë/muaj,
- ➔ viktimitë trafikimi 3000 lekë/muaj,
- ➔ viktimitë dhunë 3000 lekë/muaj,
- ➔ për fëmijët të vendosur në shërbim kujdestarie 9000 lekë/muaj.+25000lekë në vit për fëmijët që ndjekin shkollën
- ➔ për fëmijët me aftësi të kufizuara të vendosur në kujdestari 10 000 lekë/muaj

Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh është:

- ➔ për trinjakë, 3000 (tremijë) lekë për çdo fëmijë;
- ➔ për katërnjakë, 4000 (katërmijë) lekë për çdo fëmijë;
- ➔ për pesnjakë, 5000 (pesëmijë) lekë për çdo fëmijë

pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki apo njësitë administrative për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë me kartën e identitetit të aplikantit dhe kopjet të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes, për fëmijët nevojiten certifikata. Personat që disponojnë tokë duhet të paraqesin edhe dokumentin e pronësisë së tokës. Në 9 qarqet e tjera të vendit vazhdon paraqitja e dokumentacionit në bashki. Këto dokumente përfshijnë: vërtetimin si punëkërkues i papunë për të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë,

cilën zbatohet sistemi elektronik i ndihmës ekonomike që nga qershori 2014 është 31.000 familje apo individë aplikues. Ndërsa në 9 qarqet e tjera numri i aplikuesve, i hedhur në Regjistrin Elektronik Kombëtar është 64.000 familje apo individë aplikues. Shifra për personat që komisionohen për aftësinë e kufizuar ndryshon çdo muaj. Gjatë muajit shtator 2017 janë rikomisionuar dhe komisionuar për herë të parë 30581 persona, prej të cilëve janë vlerësuar nga komisioni mjekësor si persona me aftësi të kufizuara 27740 individë.
Cilat janë masat që merren për fëmijët në situatë rruge, pra që janë të pastrehë?

shtetërore, pilotoi projektin "Për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge" në qytetin e Tiranës. Gjatë këtij projekti u ndërtaua dhe implementua metodologjia e punës me fëmijët në situatë rruge, e cila u transferua si model në bashkitë e qyteteve të tjera me ndihmën e Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Si e realizon misionin e tij SHSSH?

Këtë mision e realizon nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe 12 Drejtorive Rajonale të ShSSH në 61 njësi të qeverisjes vendore, 28 Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për individë në nevojë si: fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, viktime të dhunës në familje, viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, individë e familje në situatë emergjence si dhe në partneritet me aktorë joshetërorë.

Sa qendra të shërbimeve për individë në nevojë administrohen nga SHSSH?

Shërbimi Social Shtetëror administron në nivel kombëtar 12 qendra të Shërbimeve Shoqërore për individë në nevojë dhe monitoron e financon shërbimin në 16 qendra të tjera të shërbimeve të përkujdesit social. Gjithashtu, bën monitorimin për zbatimin e legjislacionit për shërbimet shoqërore në të gjithë vendin. Bën vlerësimin vjetor të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror me objektiv prioritar ofrimin e shërbimeve komunitare, ditore sa më pranë individit.

Cilat janë fondet që programohen nga ky institucion?

SHSSH programon dhe detajon fondet për ndihmën ekonomike, për pagesat e personave me aftësi të kufizuara; e për shërbimet shoqërore. Ndërkohë SHSSH kontrollon zbatimin e legjislacionit dhe përdorimin e fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuara dhe shërbimet shoqërore. SHSSH bën edhe administrimin e Regjistratit Elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike në tre qarqe Tiranë, Durrës edhe Elbasan. Madje ky institucion administron Arkivin Elektronik të përfituesve të aftësisë së kufizuar, kujdestarëve të tyre dhe invalidëve të punës.

Cilat janë disa nga problematikat që has institucionit juaj?

Aktualisht SHSSH është në proces implementimi të dy reformave të rëndësishme: shtrirja në të gjitha qarqet e skemës së re të ndihmës ekonomike dhe pilotimi i sistemit të ri për vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar. SHSSH asiston Bashkitë për hartimin dhe miratimin e planeve sociale me objektiv ngritjen e shërbimeve shoqërore sa më pranë grupeve në nevojë sipas nevojave të identifikuar. SHSSH bashkëvepron me bashkitë për aftësimin e burimeve njerëzore.

Trajtimi i fëmijëve në situatë rruge është detyrë funksionale e bashkive dhe posaçërisht punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në drejtorinë apo seksionin e shërbimeve shoqërore pranë bashkisë.

Përfaqësuesi i ShSSH është pjesë e tryezës teknike kur kjo kërkohet nga përfaqësuesi i Bashkisë. Në vitin 2015, ShSSH me asistencën e UNICEF dhe partnerëve jo

Kostandin Bodini: Nuk është hera e parë që ndodhin ngjarje të tilla, të merren masa

Sarandë, u plagos me thikë në ambientet e shkollës, 17-vjeçari: Ndodhi prej bullizmit

"Nuk e prisja që debati do degradonte deri në këtë pikë"

Ina Allkanjari

Nuk e prisja që një zënkë e vogël të de gradonte në plagosje me thikë, për më tepër brenda ambienteve të shkollës. Që në 9-vjeçare shokët e klasës e ngacmonin, mendoj se debati shkoi deri në këtë pikë prej bullizmit". Kështu është shprehur dje për "Gazeta Shqiptare" 17-vjeçari Kostandin Bodini, pas sherrit të ndodhur disa ditë më parë në ambientet e shkollës së mesme profesionale, "Antonia Athanas", në Sarandë. 17-vjeçari, i cili u plagos me thikë nga shoku i tij i klasës thekson se bashkëmohatari i tij e sulmoi për shkak të bullizmit të ushtruar ndaj tij për një periudhë të gjatë kohe. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" i riu justifikon veprimin e shokut të klasës duke treguar arsyet e këtij xhesti, ndërkohe kërkon të merren më shumë masa sigurie në gjimnaz. Gjithashtu, Bodini shpreh se konflikti nuk do vazhdojë më tej, por uron ndërgjegjësime të bashkëmohatarëve të tij që një ngjarje e tillë të mos përsëritet më.

Mund të na tregoni se si ndodhi konflikti mes jush dhe shokut tuaj të klasës, ditën e hënë?

Nisi si një debat i vogël me fjalë brenda në klasë. Në konflikt si unë dhe bashkëmohatari im po tregonin se kush ishte më i forti. Pastaj ai u çua të më gjuante, dhe unë e godita, gjithashtu. Në një moment shoku nxori thikën dhe më qëlloi. Ne kemi dy vjet bashkë në një klasë. Ka ndodhur më përpara të kemi debate me fjalë, por vetëm kaq, jo deri në këtë pikë.

Si mendoni, pse shkoi debati deri në këtë pikë?

Atë e ngacmonin pak çunat, ushtronin bullizëm, pasi ishte me syze dhe ishte i urtë.



Kostandin Bodini, 17-vjeçari që u plagos me thikë nga bashkëmohatari

Por këto ngacmime kishin nisur që në 9-vjeçare. Mendoj se kjo ka qenë arsyeja që ai arriti deri në atë pikë, nuk besoj se ka dashur të më lëndonte.

Çfarë ndodhi pasi u plagosët?

Pas sherrit shkova vetë në spital në këmbë, u mjekova, nuk ndenja as gjysmë ore, më dhanë mjekimin e duhur, më qepën plagën, gjithashtu, mora dhe recetë. Pas kësaj vajta në komisariat nuk bëra denoncim, e mbylla çështjen dhe më qëlloi. Ne kemi dy vjet bashkë në një klasë. Ka ndodhur më përpara të kemi debate me fjalë, por vetëm kaq, jo deri në këtë pikë.

A mund të parandalohet kjo ngjarje?

Mendoj se po, n.q.s. ndërgjegjësohemi, por kjo gjë duhet të fillojë nga të gjithë

ne, duke u munduar të jemi sa më korrekt dhe miqësor me bashkëmohatarët e tjerë që gjërat mos të aprovojnë deri në këtë pikë. Kjo pasi personi që ngacmohet dëmtohet shumë psikologjikisht dhe mund të arrijë deri në një situatë të tillë. Ndaj jemi të gjithë ne që duhet t'i parandalojmë këto raste duke rregulluar gabimet në radhë të parë të vetes sonë.

A disponon shkolla masat e duhura që një rasti i tillë të mos përsëritet?

Në shkollën tonë nuk ka dhe aq masa sigurie, ka persona që ndoshta prej moshës dhe kontrollit të dobët qoftë nga familja, qoftë nga shkolla, marrin mjete si p.sh. thikë në shkollë, gjë që nuk duhet të ndodhi. Duan të duken, të bien në sy dhe ndihen të fortë. Kemi dhe

psikolog, por nuk mbaj mend të na ketë mbajtur ndonjë seancë këshillimi, apo që nxënësit t'i drejtohen për probleme të ndryshme. Nuk besoj se si psikolog është i duhuri, pasi nuk ka ardhur të na këshillojë apo të na thërrasë kur ka parë që jemi ndeshur me ndonjë problem.

A keni komunikuar pas ngjarjes me djalin që ju goditi?

Që nga momenti që ndodhi shërimi, nuk kam komunikuar me djalin. Familja ime ka pasur kontakt me familjarët e tij. Ata telefonuan dhe kërkuan falje për këtë që ndodhi dhe unë e mbylla aty problemim mes nesh.

Si reagon prindërit e tu?

Prindërit e mi ishin të shokuar më së shumti për

fakti që e gjithë kjo ndodhi brenda në shkollë. Në rrugë edhe mund të kishte ndodhur diçka e tillë, por ata u shqetësuan shumë që shërimi u zhvillua brenda në klasë, nuk e prisnin.

Ka pasur më përpara raste të tilla në shkollën tuaj?

Ka pasur raste më përpara, vjet mbaj mend një ngjarje, unë isha në vit të dytë, dhe personat që u konfliktuan ishin në vit të parë dhe ishin goditur me njëri-tjetrin. Sa kam qenë unë në këtë shkollë ka pasur dy herë konflikte që kanë shkuar deri në dhunë.

Ju jeni në vitin e fundit të gjimnazit, çfarë dëshironi të bëni pas përfundimit të shkollës?

Nuk e di n.q.s. do arrij ta realizoj, por ëndrra ime është të vazhdoj Akademine e Rendit. Është një pasion i imi që në moshë të vogël.

Një apel nga ana juaj?

Shpresoj që raste të tilla mos të përsëriten më. Por që kjo të ndodhë duhet që të rriten kushtet brenda ambienteve të shkollës. Pra të rinjtë të mësohen me idenë e këshillimit me psikologun e shkollës, vetë ky i fundit të sheshojë seancat e këshillimit me ne. Gjithashtu, të rriten masat e sigurisë dhe kontrollat brenda në shkollë. Uroj që bashkëmohatarët e mi të përpiqen mos të bëjnë diferencime mes shokëve dhe çdokush të trajtohet me respekt dhe korrektësi.



Granatë pranë një banese në Berat, familjarët në alarm

BERAT-Një banesë në fshatin Drenovicë, Ura Vajgurore, është sulmuar me granata mëngjesin e djeshëm. Mësohet se dy granata ofensive me rreze të shkurtyr veprimi janë hedhur në afërsi të banesës së shtetasit K.Hoxha. Njëra prej granatave ka shpërthyer, duke shkaktuar dëmtime të lehta në murin e banesës, ndërsa granata tjetër është çaktivizuar nga shërbimet e policisë. Uniformat blu bëjnë me dije se nga shpërthimi nuk ka njerëz të lënduar. Nga deklarimi i familjarëve mësohet se ata kanë konflikt me persona të tjerë. Ata kanë pënuar se kur ndodhi ngjarja kanë qenë të gjithë në shtëpi. Mësohet se në momentin e shpërthimit brenda në shtëpi kanë qenë gjashtë persona. "Ishim në gjumë dhe kemi dëgjuar shpërthimin e madh. U alarmuam të gjithë. Dolëm jashtë menjëherë dhe lajmëruam policinë. Pastaj erdhi policia dhe çaktivizoi granatën tjetër. Ne nuk e dimë se kush mund ta ketë bërë. Nuk kemi konflikt me askënd", tha Antoneta Hoxha, bashkëshortja e Kujtimit. Burime nga policia bëjnë me dije se po kryhen hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: ITB FOR RECONSTRUCTION OF CRÈCHE IN "DONIKA KASTRIOTI" QUARTER, BERAT MUNICIPALITY

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "RECONSTRUCTION OF CRÈCHE IN 'DONIKA KASTRIOTI' QUARTER, BERAT MUNICIPALITY".

For more details please refer to the link below:

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42054

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 9 November 2017, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
Tirana, Albania
Fax.No: + (355) 4 225 02 86
E-mail: procurement.al@undp.org

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: ITB for "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"

For more details please refer to the link below:

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42053

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 6 November 2017, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
Tirana, Albania
Fax.No: + (355) 4 225 02 86
E-mail: procurement.al@undp.org

Prokuroria e Krimeve të Rënda përveç task-forcës me antimafian e Leçes, ka nisur bashkëpunimin me antimafian e Barit. Autoritetet e dy vendeve janë detyruar të ngrënë një tjetër grup të përbashkët hetimor për shkak të sasisë së drogës së evidentuar së fundmi, e cila nisët nga brigjet shqiptare drejt Italisë. Në fokus të punës së hetuesve të dy vendeve janë grupet që trafikojnë drogë nga bregdeti shqiptar



Foto ilustruese

Nën hetim një grup kriminal nga Vlora, aktiv në trafikun e kanabisit

Krimet e Rënda, nisim bashkëpunimin me antimafian e Barit

me destinacion Barin. Prokurorët kanë mundur të identifikojnë një grup kriminal me qendër në Vlorë, i cili është mjaft aktiv në trafikun e kanabisit. Kjo bandë, sipas të dhënave të siguruar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, nuk përdor vetëm bregdetin e Vlorës, por ka nisur

ngarkesa edhe nga Divjaka dhe Kavaja. Rreth një vit më parë për shkak të situatës së krijuar me trafikun e drogës, antimafia italiane kërkoi nga prokuroria shqiptare të ngrihen grupe hetimore të përbashkëta. Rezultatet e para, bashkëpunimi i dha me goditjen e rrjetit të Habila-

jve. Krahas provave të mbledhura nga prokuroria e Katania krimet e rënda aritën të faktojnë se Habilajt kanë kultivuar disa mijëra rrënjë kanabis në Treblonjë të Vlorës, parcela, të cilat u shkatërruan në një operacion të drejtuar nga Krimet e Rënda.

SHKURT

Tre ditë i zhdukur, gjendet

I vdekur buzë rrugës
LUSHNJË - Mëngjesin e djeshëm në tokat e fshatit Kolonjë, Lushnjë, në një kanal vaditës, është gjetur nga banorë të zonës, trupi i pajetë i një personi. Sipas raportimeve kalimtarë të rastit kanë njoftuar policinë. Viktima është identifikuar si Albert Bullgari, 55 vjeç, i cili kishte tri ditë që ishte zhdukur. Ai ishte deklaruar i zhdukur nga familjarët e tij, të cilët kishin bërë denoncim në polici. Viktima sipas policisë është aksidentuar gjatë natës nga një makinë, por shoferi nuk ka ndaluar. Mendohet se trupi mund të ketë rreth 24 orë në kanal. Policia dhe një ambulancë kanë bërë transportimin e viktimës në morg ku është bërë identifikimi dhe i është nënshtruar ekspertizës mjekoligjore për të zbuluar shkakun e vërretë të vdekjes.

U kap me mina, gjykata lë në burg Golin

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për Taulant Golin, i cili ra në pranga pasi iu gjetën dy mina me telekomandë, si dhe një sasi e konsiderueshme kokainë. Antiterrori ka nisur një hetim ndaj 30-vjeçarit, për shkak të disa postimeve radikale që ai kishte bërë në rrjetet sociale. Gjithashtu, Policia po heton për gjetjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje kriminale. Kjo pasi dyshohet se Goli ka bashkëpunuar me persona të tjerë për të përgatitur minat me celularë. Dy minat të përgatitura në mënyrë artizanale me lëndë plasëse nitrat amoni, ishin lidhur me aparat celular dhe mekanizmi ishte gati për të shpërthyer. Mësohet se policia ka nisur hetimet për personat që kanë ndihmuar Taulant Golin për të prodhuar minat dhe më pas për t'i transportuar për në Tiranë. Gjithashtu, policia dyshon se minat do të përdorshin për ngjarje të rënda kriminale. Uniformat blu nuk kanë gjetur ende emrat e personave që kanë bashkëpunuar me të riun nga Librazhdi. Deri më tani, 30 vjeçari nuk ka pranuar që të flasë për grupin hetimor, duke mos dhënë asnjë dëshmi.

Policia: Procedohen në gjendje të lirë shtetasit B. Sh., A. H., blinin makinat e grabitura

Operacioni "Skrapi", vidhnin makina në Tiranë, në pranga 4 persona

Automjetet shiteshin kundrejt shumave 500 deri 1000 euro

SHITJA E MAKINAVE

Shtetasit e arrestuar vinin në Tiranë duke përdorur automjetin e markës "Opel Corsa", më pas bënin shënjestrimin e automjetit, i thyenin xhamin e pasmë dhe duke bërë zëvendësimin e centralinës bënin ndezjen e automjetit. Më pas automjetet që vidhnin i shisnin në pikat e skrapit të shtetasve B. Sh. dhe A. H. kundrejt shumave që variojnë nga 500 deri në 1000 euro.



Tiranë, finalizohet operacioni "Skrapi", 4 në pranga

za, një orë dore e marrë në automjetin e markës "Mercedes Benz" dhe pesë aparate telefonik të markave të ndryshme. Ndërkohë nga kontrollat e kryera në pikat e skrapit të shtetasve B. Sh. dhe A. H., janë gjendur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale: Katër dyer automjeti të markës "Mercedes Benz"; dy sinjale automjeti të markës "Mercedes Benz"; dy amplifikator automjeti të markës "BMW";

një diferencial automjeti i markës "Mercedes Benz"; një grup timoni automjeti i markës "Mercedes Benz"; një grup timoni automjeti i markës "BMW" dhe pjesë të ndryshme nga një automjet i markës "Volksëagen". Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Vjedhje" e kryer në bashkëpunim dhe "Përvetësimi i sendeve të vjedhura".

SHTETASIT E ARRESTUAR

- ➔ Mariglen Deva, 23 vjeç, banues në Fushë Krujë
- ➔ Denis Baroka, 29 vjeç, banues në Fushë Krujë
- ➔ Fatbardh Krova, 30 vjeç, banues në Tiranë
- ➔ Bledar Gjoka, 38 vjeç, banues në Fushë Krujë

PROCEOHEN NË GJENDJE TË LIRË

- ➔ B. Sh., 54 vjeç, banues në Fushë Krujë
- ➔ A. H., 41 vjeç, banues në Fushë Krujë

DREJTORËT E SHKARKUAR:

1. Drejtori i Burgut Peqin: Eugent Salla
2. Drejtori i Burgut Rogozhinë: Afrim Zeqiraj
3. Drejtori i Burgut Lushnjë: Gazmend Ibrahim
4. Drejtori i Burgut Lezhë: Gezim Gjeci
5. Drejtori i Burgut Berat: Ened Rrapo
6. Drejtori i Burgut Sarandë: Hajri Goxhaj
7. Drejtori i Burgut Durrës: Petri Suci
8. Drejtori i Burgut Tepelenë: Marvin Muci.

DREJTORËT E KOMANDUAR:

1. Drejtori i Burgut Peqin: Arjan Hasanaj
2. Drejtori i Burgut Rogozhinë: Syrja Malasi
3. Drejtori i Burgut Lushnjë: Zoi Russhaj
4. Drejtori i Burgut Berat: Ermal Mile
5. Drejtori i Burgut Tepelenë: Etim Lipi
6. Drejtori i Burgut Vlorë: Aleksandër Rreza
7. Drejtori e Burgut të Grave: Jelmira Sula
8. Drejtori i Burgut Fushë Krujë: Agron Hysi
9. Drejtori i Burgut Drenovë: Petri Kocia

Drejtuesit përkohësisht në detyrë, pritet përfundimi i konkursit për drejtorët

Shkarkimet në burgje, komandohen drejtuesit e rinj

TIRANË - Ministria e Drejtësisë ka komanduar dje si drejtues të rinj në burgje, punonjëz nga brenda sistemit të drejtorive përkatëse. Mësohet se drejtuesit e rinj do të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, derisa të përfundojë konkursi për drejtorët. Drejtori i

Përgjithshëm i Burgjeve Arben Çuko, ka prezantuar në Burgun e Sigurisë së Lartë, drejtorin e ri, Arjan Hasani, ndërkohë që të gjithë të komanduarit e tjerë kanë shërbyer si shefa personeli në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, apo shefa policie në burgje,

si Agron Hysi apo Surja Malasi. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, ka shkarkuar nga detyra drejtorët e burgjeve në disa qytete, duke i dërguar ata për ndjekje penale. Ministria deklaroi se drejtorët e shkarkuar akuzohen për shkelje të rënda, që rrezikojnë

sigurinë në burgje, duke theksuar se janë evidentuar edhe raste të futjes së lëndëve narkotike në burgje. Në një dalje për media, ministria Gjonaj njoftoi largimin nga detyra të drejtorëve të Burgjeve në Lezhë, Rogozhinë, Lushnjë, Peqin, Tepelenë, Sarandë, (i dënuar më parë), Berat, Durrës. Gjithashtu, deklaroi hapjen e garës për 23 drejtues të burgjeve.



Shuhet në moshën 31-vjeçare gazetaria e moderatorja Adelajda Xhamani. Shkak është bërë një atak kardiak, e në momentin e transportimit në QSUT ka qenë pa ndjenja. E ndjera ka lajmëruar mikeshën e saj duke i thënë se nuk mbushej me fryme e menjëherë kjo e fundit ambulancën, por vdekja e mori gazetaren bukurorsh. Sipas miqve të saj Adela nuk vuante nga asnjë sëmundje kronike dhe përcaktimi për atak kardiak është shkaku i largimit të parakohshëm nga jeta. Adelajda Xhamani ka punuar në "Gazeta Shqiptare" për një periudhë kohe relativisht të gjatë, ndërsa në nëntor do të realizonte emisionin e saj "Shtëpia e Adelës". Të shumta kanë qenë reagimet e njerëzve që kanë punuar e që e kanë njohur gazetaren kurajoze.

INTERVISTA

"Gjërat që kam arritur deri më sot, unë i kam kërkuar, unë jam lutur. Jam lutur për familjen time, për profesionin tim, jam lutur edhe për gjërat më minimale. Unë lutem çdo ditë, për çdo gjë të mundshme. Lutem shumë. Dhe pjesa më e madhe e lutjeve që kam bërë, Zoti m'i ka realizuar, edhe jam shumë mirënjohëse për këtë", tha në një intervistë kohë më parë Adelajda. Adelajda Xhamani ishte një besimtare e devotshme, e cila mirënjohjen dhe dashurinë për Zotin e shprehte hapur, ashtu siç kishte bërë edhe kohë më parë në një intervistë të dhënë për mediat.

Adelajda fillimisht u njoh për publikun shqiptar për pjesëmarrjen e saj në edicionin e "Big Brother 2". Pas thyerjes së shumë mentaliteteve nga vendi i saj i lindjes Kavaja, ajo fitoi simpatinë e të gjithëve. Më pas Adelajda nuk u kthye në Kavajë, ajo vazhdoi jetën e saj në Tiranë, duke ju përkushtuar anës profesionale. Pas disa dy vitesh, lidhja mes saj dhe Bjordit Mezinit përfundoi. Nga ana tjetër, Adela ishte duke ecur shumë mirë me punën e saj si gazetare. Në televizionin "Vizion Plus", "News 24", "Gazeta Shqiptare", e shumë media të tjera në shtypin e shkruar apo portale. Së fundmi ajo nisi projektin e ri në tv "Fax News", për të cilin punoi edhe pak orë para se të ndahej nga jeta. 31 - vjeçarja, e cila u nda papritur nga jeta mëngjesin e kësaj të diele, rrëfente se agjëronte çdo vit, sepse muaji i Ramazanit i dhuronte



Kush është 31-vjeçarja, intervista e fundit dhe planet e lëna në mes të kavajases kurajoze

Shuhet në moshë të re gazetaria Adelajda Xhamani

Miqtë: Nuk vuante nga asnjë sëmundje kronike, pësoi arrest kardiak

qetësi e pozitivitet. Ishte një besimtare fanatike, pavarësisht angazhimeve të shumta që ajo kishte, Adelajda nuk hiqte dorë nga agjërimi: "Ramazani është muaji që më dhuron qetësi e pozitivitet... E kam nisur agjërimin në moshë të re. Duke qenë se unë vij nga një vend mysliman dhe pjesa më e madhe janë agjëruar, kjo frymë u injektua edhe tek unë. Sigurisht kur u rrita unë i lexova librat fetarë, e studiova fenë time. E zgjodha që ta praktikoj, sepse më bën të ndihem mirë dhe e dua fenë islame."

MESAZHI I BJORDIT

Me fjalë të ndjera, që duket se i kanë dalë me vështirësi nga zemra, Bjordit Mezini ka shprehur dhimbjen për ndarjen nga jeta të Adela Xhamanit. Historia e dashurisë mes dy të rinjve u bë e famshme në "Big Brother". Lexoni më poshtë mesazhin e ndjerë të Bjordit pas ndarjes nga jeta të 31-vjeçares.

"Ti e di se sa të vështirë e kam këtë pjesë, sepse jam natyrë cinike, dhe jam i tillë pikërisht për të mos u përbalhur me momente si ky. Ti e di që nuk më

pëlqen të flas publikisht, siç domos kur bëhet fjalë për çfarë ndjej, por në fund të fundit kur filluam aventurën tonë së bashku e kemi bërë përball të gjithëve, ndaj dhe për këtë arsye përball të

gjithëve më duhet të them se çfarë ndjej. Dhe pse kundër natyrës time po i shkruaj këto fjalë për ty, për respekt të të gjithë atyre që të kanë dashur, të gjithë atyre që nuk ngopeshin me ty, sepse

iu fute atë thellë në zemër sa asnjëri më parë nuk e ka bërë. Në këto momente nuk di çfarë të mëndoje e nga t'ia nis, koka me mbushet me kujtime dhe sytë me lot. Adel, më vjen shumë inat.

Më vjen inat, sepse je personi më i fortë që kam njohur. Nuk e kam kuptuar kur rre se ku e gjeje forcën të përballoj çfarë ke përballuar gjatë gjithë jetës tende. Më vjen inat, sepse ke luftuar, gjithmonë, dhe kjo jo në mënyrë figurative, ti ke luftuar vërtet për çdo gjë që arrite në jetë dhe sikur mos të mjaftonte, arrite të frymëzoje një gjeneratë të tërë me forcën tënde.

Linde në një botë shumë të vogël për ty dhe luftove atë shumë për të zgjeruar kufijtë e botës tënde sa asnjëri tjetër që kam njohur. Kur kuptove që kjo nuk mjaftonte fillon të luftoje për të ndryshuar veten tënde dhe pak veta janë atë që zgjuan dhe të guximshëm për ta bërë këtë.

Linde në një botë shumë të egër Adela, një botë që, gjithsesi, ka humbur çdo betejë kundër teje, sepse nuk e dinte kë kishte përballë.

Kjo botë nuk e dinte që Adela nuk ka frikë nga asgjë, por kësaj radhe nuk kishte se si të fitojte Adel, sepse u luajt jashtë rregullave, dhe ishte e vetmja mënyrë për të të mundur.

Adel, nuk jam i mirë me fjalët dhe ti e di se sa pak natyrë spirituale jam, do të doja të kisha thënë shumë më shumë, por më beso kur të them që dhe kaq paska qenë tmerrsisht e vështirë. Faleminderit Zëmër, për çdo gjë dhe më fal, për çdo gjë!"



Projektligji parashikon edhe një pagesë bazë prej 70 mijë lekësh

Drafti për 10 mijë minatorët do të shqyrtohet në Kuvend

Nikollë Gjoka: Të ulet vjetërsia në punë

Për herë të parë punonjësit e nëntokës do të kenë një trajtim të veçantë shëndetësor dhe financiar. Kjo pasi projektligji për Statusin e Minatorit, është depozituar nga qeveria për t'u shqyrtuar në Kuvendin e Shqipërisë. Për 27 vite me radhë, minatorët kanë kërkuar të drejtat e tyre e në veçanti zbatimin e Statusit të Minatorit, i cili ende nuk është miratuar nga shteti. Prej dy vitesh, ish-minatorët, Nikollë Gjoka dhe Dedë Marku, kanë punuar për hartimin e këtij drafti që kërkon zbatimin e statusit. Një ndër pikat kyçe që përcaktohet në draft është ulja e vjetërsisë së punës në minierë, pasi minatorët kërkojnë uljen e saj nga 15 vite në 10 vite e 6 muaj. Në një prononcim për "Ora News", Nikollë Gjoka, një nga hartuesit e draftit thotë se kërkojnë që Statusi i Minatorit të shoqërohet me 50% të pensionit shtesë page. "Ne kemi bërë një propozim, që Statusin e Minatorëve ta përfitojnë dhe të dalin në pension me 10 vite e 6 muaj. Kush ka plotësuar 55 vite moshë, ka punuar 10 vite e 6 muaj në minierë t'i jepet e drejta e Statusit të Minatorit. Statusi i Minatorit të shoqërohet me 50% të pensionit shtesë page. Me një përllogaritje page me pagën minimale 100%. Pra, në qoftë se ka qenë paga 24 mijë të shkojë 48 mijë ose 35 mijë në 70 mijë. Kemi kërkuar që çdo vit mbi 10 vite e 6 muaj, të shoqërohet me një shtesë 3%", -u shpreh ai. Janë rreth 10 mijë minatorë në të gjithë vendin që përfitojnë nga statusi, ku do të përfshihen edhe mbi 2



mijë punonjës të prekur nga reformat, ish- të dënuarit e regjimit komunist që kanë punuar në miniera apo personat që kanë pësuar dëmtime invaliditeti. Ndërkaq, Dedë Marku, hartuesi tjetër i draftit thotë se parashikohet që të përfitojnë rreth 8-

10 mijë minatorë nga ky status. "Do të përfitojë edhe personeli i inxhinierëve teknik dhe drejtues, të cilët kanë punuar në administratën e nëntokës; përfitojnë të gjithë ish-të dënuarit politikë, të cilët gjatë vuajtjes së dënimit kanë punuar në miniera në nëntokë; punonjësit shpëtues dhe inspektorët e reparitit të inspektimshpëtim minierave, të cilët plotësojnë kriteret", - tha Marku. Në këtë projektligj, minatorët kanë kërkuar, gjithashtu, që për punën e nëntokës të vendoset një pagesë bazë prej 70 mijë lekësh në muaj dhe për çdo vit të aplikohet shtesa për vjetërsinë në pozicionin e punës. "Për punëtorët që punojnë në minierë paga minimale të jetë 70 mijë lekë. Kush punon për 3 vjet në nëntokë pas 3 vitesh të marrë 5%, mbi 5 vjet, 8%; dhe mbi 10 vjet, 15% shpërbllim

PAGESA

"Për punëtorët që punojnë në minierë paga minimale të jetë 70 mijë lekë. Kush punon për 3 vjet në nëntokë pas 3 vitesh të marrë 5%, mbi 5 vjet, 8%; dhe mbi 10 vjet, 15% shpërbllim për vjetërsinë në punë mbi pagën bazë", - theksoi Marku.

spitalet publike dhe private si dhe jashtë vendit. Duke marrë shkas nga sëmundshmëria e këtyre punonjësve, kërkohet që të ngrihet një repart për sëmundjet e silikozës. Aktualisht në sektorin e minierave janë të punësuar 10-12 mijë punonjës.

STATUSI

"Ne kemi bërë një propozim, që Statusin e Minatorëve ta përfitojnë dhe të dalin në pension me 10 vite e 6 muaj. Kush ka plotësuar 55 vite moshë ka punuar 10 vite e 6 muaj në minierë t'i jepet e drejta e Statusit të Minatorit. Statusi i Minatorit të shoqërohet me 50% të pensionit shtesë page, - tha Gjoka.

Klosi: T'i japim zgjidhje përfundimtare

Do të mbyllen pikat e skrapit që s'plotësojnë kushtet

Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve të automjeteve dhe metaleve të tjera, që nuk plotësojnë kushtet e ushtrimit aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë së Tiranës do të mbyllen. Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të mbështetura nga Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, nisën dje në terren aksionin për verifikimin e dokumentacionit dhe mbylljen e të gjitha pikave të skrapit që funksionojnë në Tiranë, në kundërshtim me parashikimet ligjore mjedisore dhe për të cilat ka pasur edhe anketa nga qytetarët në portalin "Bashkëqeverisja me qytetarët". Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi dhe nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arbian Mazniku morën pjesë në aksionin e djeshëm që u fokusua në disa nga pikat më të mëdha të grumbullimit të mbetjeve për skrap që funksiononte në zonat e banuara, ndërsa theksuan se aksioni do të vijojë në gjithë territorin e Tiranës për të vazhduar më pas në gjithë vendin. "Kemi ardhur këtu për të parë një nga problematikat më të mëdha, atë të zgjidhjes përfundimtare të zonave të cilat mbledhin skrapin, zonave, të cilat mbledhin mbetjet urbane të qytetit, të cilat kryhen jashtë normave të plotësimit të lejes mjedisore", - tha ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi.

STRATI

Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"-Truall", me sipërfaqe 3200 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 13, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotek Nr. 449 Rep., Nr. 211/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 89,600 Euro;

"-Truall" së bashku me depozitë karburanti, me sipërfaqe 4419 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 14, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotek Nr. 448 Rep., Nr. 210/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 162,036 Euro.

Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 06.11.2017. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

INVESTIMI



Spitali i Traumës, Rama: Para 4 vitesh ishte një ambient luftë

Spitali Universitar i Traumës tashmë do të mirëpresë të gjithë pacientët e tij me shërbime bashkëkohore dhe cilësore. Kryeministri i vendit, Edi Rama, i shoqëruar nga ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, e vlerësuan këtë investim si një faqe të re për spitalin e Traumës. Kryeministri Rama u shpreh se pas këtij investimi madhor Spitali i Traumës mund të akreditohet dhe të certifikohet nga Bashkimi Europian. "Para katër vitesh, ishte një spital luftë, se nuk ishte vënë më dorë. Tani është një gjë krejt tjetër dhe fakti që është i gatshëm për t'u akredituar e për t'u certifikuar me certifikatat e Bashkimit Europian, duke filluar nga gjithë instrumentet mjekësore, procesi i sterilizimit, plus dhe gjithë zonat e reja të priftjes, të trajtimit, të rehabilitimit, është realisht një ëndërr që bëhet realitet. Sigurisht që ka ende shumë për të bërë, por ambicia është që të njiqet cilësi ta çojmë në të gjithë spitalet rajonale të Shqipërisë. Ajo që është themelore është se investimet janë bërë e po bëhen me shumë vëmendje, për të mos harxhuar për gjëra të panevojshme, por për të filluar me më të nevojshmet, për t'i shkallëzuar deri te plotësimi i të gjithë ciklit", - theksoi kryeministri. Ndërsa ministria e Shëndetësisë, Manastirliu u shpreh se janë bërë investime radikale për ndryshimin e spitalit. "Janë dy investime radikale që janë kryer për ndryshimin e të gjithë shërbimeve, nga Urgjenca, Reanimacioni, shërbimet priftëse dhe pastaj është realizuar gjithë pajisja e plotë me aparaturat biomjekësore dhe pajisjet spitalore", - u shpreh Manastirliu.

unicef for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Conduct a Research on Children's Experiences of Internet Use in Albania.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (www.unicef.org/albania) to download the detailed RFPS solicitation document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: "LRPS-2017-9135451 - Research on Children's Experiences of Internet Use" to the address below:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencisë të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 2273 335/6/7/8/9; fax: +355 4 2243 775 /6
Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **13 November 2017, 16:30 hrs.**

Gara zhvillohet mes kandidatëve të LSDM-së dhe VMRO DPMNE-së

Zgjedhjet lokale në Maqedoni, pjesëmarrje e ulët e shqiptarëve në votim

MOST: Raundi i dytë, ishte proces i rregullt

Egla Xhemali

MAQEDONI

Gjatë ditës së djeshme u zhvilluan zgjedhjet e raundit të dytë në Maqedoni për kryetarët e komunave. Procesi zgjedhor, sipas Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, u zhvillua në mënyrë demokratike, ndërsa deri në orën 10, të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar 8.9 për qind të qytetarëve me të drejtë vote. Dalja më e ulët edhe në raundin e dytë është regjistruar në komunat e banuara me popullatë shqiptare. Sipas KSHZ-së, vendotimet janë hapur me kohë dhe deri në paraqitjen e parë për media nuk janë regjistruar parregullsi. Edhe asociacioni qytetar "MOST" që ka numrin më të madh të vëzhguesve, ka njoftuar për proces të rregullt zgjedhor dhe hapjen me kohë të qendrave të votimit.

Në 35 komuna të Maqedonisë po zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve lokale ku të drejtën e votës e kanë 833.716 qytetarë të regjistruar në listën e përgjithshme zgjedhore. Votimet që nisën në orën 7 u zhvilluan në 1,517 vendvotime. Për dallim nga raundi i parë i zgjedhjeve më 15 tetor, kur u votua edhe për këshillat komunalë dhe qytetin e Shkupit, këtë herë u votua vetëm për kryetarët të komunave, që kaluan në balotazh ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë më



Foto ilustruese

ZJEDHJET

Në 35 komuna të Maqedonisë po zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve lokale ku të drejtën e votës e kanë 833.716 qytetarë të regjistruar në listën e përgjithshme zgjedhore. Votimet që nisën në orën 7 u zhvilluan në 1,517 vendvotime. Për dallim nga raundi i parë i zgjedhjeve më 15 tetor, kur u votua edhe për këshillat komunalë dhe Qytetin e Shkupit, këtë herë u votua vetëm për kryetarët të komunave.

la dhe të tjerat janë kryesisht në zonat rurale. Edhe në këtë balotazh, gara zhvillohet mes kandidatëve të LSDM-së së kryeministrit, Zoran Zaev dhe VMRO DPMNE-së ish-kryeministrit, Nikolla Gruevski. Për raundin e dytë të zgjedhjeve janë akredituar 5,101 vëzhgues vendorë dhe 473 të huaj. Zgjedhjet do të mbikëqyren edhe nga delegacioni i BE-së, ambasada amerikane, e cila ka akredituar 35 vëzhgues, ndërsa ka edhe vëzhgues nga vende tjera, si nga Britania e Madhe, Franca, Rusia, Shqipëria, Kosova e vende tjera. Rezultatet e para nga balotazhit pritet të nisin të publikohen në mënyrë elektronike në faqen e internetit të KSHZ-së pavarësisht se si arrijnë nga qendrat e votimit, por ashtu sikur edhe në rrethin e parë rezultatet do të publikohen më herët nga partitë politike që kanë anëtar dhe vëzhgues nëpër të gjitha vendotimet, shkruan REL. Maqedonia ka gjithsej 80 komuna dhe Shkupi ka përfunduar në qytetet më të mëdha përfaqësim edhe Shkupin, ndërsa kanë mbetur disa qytete më të vog-

GARA
Gara kryesore zhvillohet kryesisht në komunat shqiptare, pasi nga 14 prej tyre me shumicë shqiptare, në raundin e parë janë zgjedhur kryetarët e vetëm dy komunave. Beteja po zhvillohet për komunat e Çairit në Shkup, Tetovë, Gostivar, Strugë, Dibër, si dhe komunat tjera që janë në zonat rurale. Gara zhvillohet mes kandidatëve të BDI-së, e cila ka mbështetjen e LSDM-së dhe atyre të koalicionit Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa.

shumë vota në rrethin e parë të zgjedhjeve. Në garë janë 68 kandidatë të 8 subjekteve politike dhe 2 kandi-

datë të pavarur. Gara kryesore zhvillohet kryesisht në komunat shqiptare, pasi nga 14 prej tyre me shumicë

shqiptare, në raundin e parë janë zgjedhur kryetarët e vetëm dy komunave. Beteja po zhvillohet për komunat e

Çairit në Shkup, Tetovë, Gostivar, Strugë, Dibër, si dhe komunat tjera që janë në zonat rurale. Gara zhvillohet mes kandidatëve të BDI-së, e cila ka mbështetjen e LSDM-së dhe atyre të koalicionit Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa. Te blloku politik maqedonas gara ka përfunduar në qytetet më të mëdha përfaqësim edhe Shkupin, ndërsa kanë mbetur disa qytete më të vog-

36-vjeçarja mbante lidhjet mes dy vendeve

Arrestohet në Itali e dashura e "Pablo Escobar-it" shqiptar, iu gjetën 22 kilogram hashash

ITALI - Është arrestuar në Montichiari, afër Brescias të Italisë, e dashura e një bosi shqiptar të drogës ndër më të kërkuarët në Europë, i cili njihet ndryshe edhe si "Pablo Escobar" i Tiranës. Bëhet fjalë për "një arrestim që hap skenarët ndërkombëtarë të hetimit mbi trafikun e drogës të destinuar për krahinën e Brescia-s dhe në përgjithësi në Italinë veriore", shkruajnë mediat italiane. Sipas tyre, 36-vjeçarja, identiteti i së cilës nuk bëhet ende i ditur, është kapur me 22 kilogram hashash. Ajo konsiderohet si e dashura e bosit shqiptar, i njohur si pronari i një zinxhiri klubesh të natës, për të cilin ka një urdhër ndërkombëtar arresti, e që policia shpreson ta kapë sa më parë. Kjo e fundit strehohej në shtëpinë e një bashkëkombësi të saj 40-vjeç, i dënuar më herët me arrest shtëpie për akuzën e vjedhjes. Në



Droga e sekuestruar nga policia italiane

momentin kur policia ka hyrë në banesë, ajo është fshehur në dollapin e rrobave, por u arrit të kapet. Nga hetimet rezultoi se 36-vjeçarja kishte si detyrë të mbante të gjalla lidhjet mes eksportuesve shqiptarë të drogës dhe

partnerëve të tyre në Itali, në zona si Brescia, Milano e Bergamo. Sakaq, policia thotë se e ka gjetur 40-vjeçarin shqiptar, teksa paketonte hashashin në cilindra të presuar, për ta shitur më pas. Pas arrestimit të së dashurës

36-vjeçarja kishte si detyrë të mbante të gjalla lidhjet mes eksportuesve shqiptarë të drogës dhe partnerëve të tyre në Itali, në zona si Brescia, Milano e Bergamo.

dhe njeriut që e mbronte atë, hetimet kanë shkuar deri tek shoferi i boss-it shqiptar, për të cilin s'ka ende asnjë të dhënë. Sipas të dhënave të para, flitet se droga vinte me anije në portet italiane përmes Adriatikut.



Turqia feston "Republikën", kurora me lule te busti i Kemal Atatürkut

Turqia festoi dje Ditën e Republikës, me anë të së cilës shënohet shpallja e republikës turke më 29 tetor në vitin 1923. Ditëlindja e 94 e republikës turke do të shënojë 94 manifestime në të gjithë territorin e vendit. Festa ka nisur që ditën e shtunë, por ajo do të zgjasë 35 orë, ndërsa nuk do të mungojnë tubime popullore, marshime dhe manifestime të shoqëruara me muzikë. Me këtë rast janë vendosur kurora me lule në bustin e themeluesit të Turqisë modern, Mustafa Kemal Atatürk në kryeqytet të shtetit turk. Sistemi republikan në Turqi është vendosur më 23 prill të vitit 1920, kur është formuar Kuvendi i madh nacional, i cili ia mori pushtetin sulltanit, por Republika zyrtarisht është shpallur nga ana e Atatürkut në ditë të sotme tre vite më vonë. Pas shpalljes zyrtare të Republikës së Turqisë më 29 tetor të vitit 1923, Atatürk është zgjedhur presidenti i parë turk.




PARANDALIMI I HERSHËM



Mjekë e psikologë organizojnë trajnimin mbi shëndetin mendor në punë

DIETAT QË DUHET TË PËRDORNI



10 mënyra për të parandaluar rrezikun nga diabeti

Vlera Lekaj:

♦ Trajtim me antibiotikë për rastet kronike, kujdes me komplikacionet



Infeksionet urinare, ja kategoritë më të prekura

"Konsumoni sa më shumë lëngje dhe raciononi kripën"

• Pini çaj mali për uljen e tensionit të gjakut. Konsumoni brokoli për një stomak të shëndetshëm

Mjekja: Trajtim me antibiotikë për rastet kronike, kujdes me komplikacionet

Vlera Lekaj:

Infeksionet urinare, ja kategoritë më të prekura

"Konsumoni sa më shumë lëngje dhe raciononi kripën"

Voltiza Duro

Jemi në një periudhë të ndryshimit të klimës dhe virusat tashmë kanë trokitur. Stina e vjeshtës shqërohet dhe me shfaqjen e infeksioneve të traktit urinar, duke shkaktuar një gjendje shëndetësore dhe fizike jo të mirë. Në një intervistë të dhënë për suplementin "Life pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja Vlera Lekaj tregon simptomat kryesore të kësaj sëmundjeje, mënyrat e diagnostikimit dhe kategoritë më të prekura. Gjithashtu, mjekja thekson se konsumimi i lëngjeve, racionimi i kripës e aktiviteti fizik janë hapat parandalues për infeksionet urinare.



Parandalimi i infeksioneve urinare duhet të ketë një vëmendje të veçantë të çdo individ. Konsumimi i lëngjeve të vazhdueshme, çajrat bimorë ndihmojnë organizmin të vetëpastrohet nga bakteret. **Uji siguri është kryefjala, kur flasim për konsumim lëngjesh.**

Çfarë janë infeksionet urinare?

Infeksionet e traktit urinar mund të prekin rrugët e sipërme të tij, duke përfshirë veshkën dhe ureterët ose rrugët e poshtme të tij, vezikën urinare dhe uretrën.

Cilat janë simptomat që tregojnë se individit është prekur nga kjo sëmundje? Shenjat dhe simptomat më të shpeshta të këtyre infeksioneve janë: urinim i shpeshtë, djegie ose dhimbje gjatë urinimit, dhimbje abdominale, dhimbje mesi si dhe turbullim i ngjyrës së urinës.

Shpeshherë të sëmurët ankohen për një periudhë të gjatë

ndërkohë që kemi një maskim të një infeksioni urinar.

Si diagnostikohet infeksioni urinar?

Infeksioni urinar zbulohet me një analizë të thjeshtë të urinës. Kështu që një dobësi trupore e zgjatur si dhe dhimbje e kockave mund të jetë një moment kur duhet të konsultoheni me mjekun tuaj.

Cilët persona janë më të predispozuar ndaj kësaj sëmundjeje?

Sigurisht që individët, të cilët kanë një predispozicion të caktuar, janë të prirur të preken nga infeksione urinare të shpeshta dhe të përsëritura, pra kronike. Imunodeficienca sigurisht është ndër problemet shëndetësore më të vështira, e cila të përball me infeksione të përgjithshme, të përsëritura ku ndër këto hyjnë dhe infeksionet urinare. Të sëmurët me diabet, gjithashtu, janë të ekspozuar përballë infeksioneve urinare të shpeshta.

A ndikojnë problemet me veshkat në infeksionet urinare?

Problemet me gurët apo grumbullimet kristalore në veshkë, shkaktajnë infeksione urinare kryesisht të rrugëve të poshtme, për shkak se lëvizjet e kristaleve përgjatë rrugëve urinare apo të gurit të veshkës, dëmtojnë mukozën e rrugëve të poshtme urinare duke



Mjekja Vlera Lekaj

pastrimin e rrugëve urinare dhe mund të merren dhe më gjatë, si terapi natyrale parandalimi të infeksioneve urinare në të ardhmen. Ndër çajrat më efektivë për pastrimin e rrugëve urinare janë ato me rrënjë hitre si dhe çaji i boronicës.

Po në rastet kur paraqitet më i rëndë, si bëhet mjekimi?

Jo gjithmonë infeksioni urinar kalon lehtë, shpesh herë mund të shfaqet rezistent që në thelb ka një shkaktar patogen specifiç, i cili kërkon një mjekim, po ashtu më specifik. Për të evidencuar patogenin shkaktar në rastet e infeksioneve urinare rezistente, na duhet të marrim një urokulturë, pra të bëjmë një mbjellje të urinës. Ndër shkaktarët më të shpeshtë është bakteri Escheria Coli, i cili në vetvete ka një specifikë të qenit tepër rezistent dhe i vështirë për t'u çrrënjësuar. Në raste të shumta rezistente ndaj mjekimit provohen terapi me lloje të ndryshme antibiotikësh.

Kur shfaqet i komplikuar një infeksion urinar?

Përveçse rezistent një infeksion urinar mund të paraqitet dhe i komplikuar, në rastet kur shoqërohet dhe me infeksione të tjera.

Të meshkujt një infeksion urinar duhet përherë të merret si i komplikuar për shkak të shoqërimit në shumicën e rasteve dhe me uretritë apo prostatit. Si raste të tjera të infek-

sioneve urinare të komplikuar veçoj dhe shoqërimin e tyre me infeksione mykotike, që kanë shkak Kandidën, dhe si pasojë rekurenca e këtyre infeksioneve është e madhe. Femrat duhet të kenë sidomos kujdes, nëse shenjat e një infeksioni urinar persistojnë edhe pas mjekimit përkates, të marrin në konsideratë prezencën e një infeksion mykotik.

Si mund të parandalohen infeksionet urinare?

Parandalimi i infeksioneve urinare duhet të ketë një vëmendje të veçantë të çdo individ. Konsumimi i lëngjeve të vazhdueshme, çajrat bimorë ndihmojnë organizmin të vetëpastrohet nga bakteret. Uji sigurisht është kryefjala, kur flasim për konsumim lëngjesh. Çdo person që të ketë hidratimin e nevojshëm duhet të pijë të paktën 2 litra ujë në ditë. Një dietë të posaçme duhet të ndjekin dhe individët që kanë gurë në veshkë apo grumbullime kristalesh. Ku racionimi i kripës dhe ushqimeve me nivele të larta të kripës është një domosdoshmëri për këto raste. Një këshillë praktike është edhe kujdesi gjatë dushit, ku nuk rekomandohet për shpëlarje të zonës intime, përdorimi i sham-pove, sapunëve apo përbërje të tjera me efekte irrituese. Për një trakt urinar pa probleme, duhet një punë e mirë e veshkës.

Jemi në ditët e fundit të muajit të ndërgjegjësimit lidhur me shëndetin mendor. Në kuadër të tij, janë zhvilluar aktivitete që kanë pasur në fokus të folurit rreth problemeve të shëndetit mendor, stigmës dhe diskriminimit që i shoqëron ato si dhe mënyrat e parandalimit të këtyre sëmundjeve. "Shëndeti mendor në punë" është slogani mbi të cilën janë mbajtur trajnime e aktivitete të ndryshme sensibilizuese gjatë tetorit. Para disa ditësh, Sektori i Shëndetit Mendor, në Departamentin e Promocionit të Shëndetit, Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me APRA (Albaniana Psychosocial Rehabilitation Association), Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, organizuan një trajnim me temë: "Shëndeti mendor në punë". Në këtë trajnim morën pjesë mjekë, psikologë, infermierë, studentë, etj. Temat që u trajtuan ishin: "Shëndeti mendor dhe parandalimi i problemeve të lidhura me të", "Shëndeti mendor në punë", "Stresi në punë dhe mënyrat e menxhimit të tij". Pas secilit prezantim u la një hapësirë për pyetje, komente dhe ndarje eksperiencash nga të pranishmit. Në fakt, shëndeti mendor në punë, përbën një aspekt për të cilin pak është folur, por sigurisht që përmban një rëndësi të madhe për secilin, për ata që janë në marrëdhënie pune, për ata që e kanë humbur punën, për ata që po kërkojnë punë etj. Puna është një pjesë e qenësishme e individit në moshën e rritur. Ajo përbën një mënyrë për të shpalosur veten, është mënyrë për të siguruar mbijetesën dhe të ardhurat e nevojshme, për të pasur një pozicion në shoqëri, etj.

Çrregullimet mendore

Çrregullimi mendor është një sjellje klinike domethënëse, sindromë psikologjike apo model sjelljeje që shoqërohet me shqetësim, me paaftësi, apo me një rrezik të shtuar vdekjeje, dhimbjeje, disabiliteti apo humbje të rëndësishme lirie. 5% deri 15% e fëmijëve gjatë jetës provojnë një çrregullim psikiatrik që është mjaftueshëm i theksuar për të kërkuar trajtim. Për fat të keq, shumë prej çrregullimeve të fëmijërisë kalojnë pa u kuptuar dhe pa u trajtuar, prandaj identifikimi i hershëm dhe trajtimi zë një vend të rëndësishëm. Çrregullimet që shihen më shpesh në klinikat e psikiatrisë së fëmijëve ose në mjediset e praktikës familjare përfshijnë çrregullime të zhvillimit intelektual, çrregullime të komunikimit, çrregullime të spektrit autik, çrregullimin e vëmendjes së pamjaftueshme dhe hiperaktivitetin (ADHD), çrregullimet specifike të të mësuarit dhe çrregullimet motore. Përveç këtyre, një pjesë e atyre çr-



Parandalimi i hershëm mund të evitojnë kalimin e pacientit në gjendje psikoze

Mjekë e psikologë organizojnë trajnimin mbi shëndetin mendor në punë

5% -15% e fëmijëve provojnë një çrregullim psikiatrik



"Shëndeti mendor në punë" është slogani mbi të cilën janë mbajtur trajnime e aktivitete të ndryshme sensibilizuese gjatë tetorit. Para disa ditësh, Sektori i Shëndetit Mendor, në Departamentin e Promocionit të Shëndetit, Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me APRA (Albaniana Psychosocial Rehabilitation Association), Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, organizuan një trajnim me temë: "Shëndeti mendor në punë".

regullimeve që hasen te personat e rritur, zakonisht vihen re edhe te fëmijët, sikundër janë depresioni madhor, çrregullimi bipolar dhe rrallë skizofrenia.

Faktorët

Ndërsa simptomat variojnë dukshëm, çrregullimet mendore karakterizohen në përgjithësi nga disa turbullime të mendimeve, emocioneve sjelljes dhe marrëdhënieve anormale me njerëzit e tjerë. Dëshmitë shkencore moderne tregojnë se çrregullimet mendore dhe të sjelljes janë rrjedhojë e bashkëveprimit të gjenetikës dhe ambientit, me fjalë të tjera i bashkëveprimit të faktorëve biologjikë me ata psikologjikë dhe socialë. Nga periudha e paralinjës dhe gjatë gjithë jetës, gjenet dhe ambienti marrin pjesë në një varg bashkëveprimesh të pashmangshme. Këto bashkëveprime janë themelore në zhvillimin e çrregullimeve mendore dhe të sjelljes.

Masat parandaluese

Ekzaminimi i faktorëve të riskut ka zbuluar se shumë nga këto çrregullime mund të jenë të kthyeshme. Për shembull,

përçarja e rrethit të bashkëmoshatarëve dhe atij familjar, ndodhin afër, madje edhe para fillimit të episodit të parë psikotik. Vëmendja ndaj këtyre sferave të jetës, si pjesë e trajtimit, ka potencialin që të kufizojë apo të riparojë dëmtimin. Ndërrhyrja e hershme dhe e gjërë mund të kapë pacientet në stadin e tyre parapsikotik dhe mundësisht të parandalojë ose vonojë kalimin e tyre në psikoze. Aktualisht, më e mira që mjekët synojnë është parandalimi, ndërhyrja sekondare në individët të cilët tashmë janë simptomatikë dhe me dëmtim të funksionimit, për të reduktuar gjasat e përkeqësimit të gjendjes së tyre. Kujdesi për pacientët me rrezik shumë të lartë fokusohet në trajtimin e simptomave të ndryshme dhe deficiteve funksionale, pa pritur për një diagnozë strukturale. Në shekullin e 21, qëllimi i trajtimit të hershëm duhet të jetë shërim sa më i plotë i mundshëm, ku njerëzit në çdo stad të skizofrenisë do të konsiderohen si njerëz që mund të arsimohen, të punësohen dhe të jenë të aftë të jetojnë një jetë normale.

Aktiviteti fizik i vazhdueshëm ndalon progresin e sëmundjes

10

mënyra për të parandaluar rrezikun nga diabeti

Ja dietat që duhet të përdorni

Diabeti është një sëmundje kronike që prek miliona njerëz në mbarë botën. Rastet e pakontrolluara mund të shkaktojnë verbëri, dështim të veshkave, sëmundje të zemrës dhe kushte të tjera serioze. Para se të diagnostikohet diabeti, ekziston një periudhë ku nivelet e sheqerit në gjak janë të larta, por jo aq të larta sa të diagnostikohen si diabet. Kjo njihet si prediabet. Është vlerësuar se deri në 70% e njerëzve me prediabet vazhdojnë të zhvillojnë diabetin e tipit 2. Për fat të mirë, përpunimi nga prediabeti në diabet nuk është i pashmangshëm. Edhe pse ka disa faktorë që nuk mund të ndryshoni, siç janë gjenet, moshja apo sjelljet e kaluara, ka shumë veprimë që mund të ndërmerrni për të zvogëluar rrezikun e diabetit. Më poshtë po japim 10 mënyra për të shmangur rrezikun nga diabeti.



Ndëlni një dietë me sasi të ulët karbohidratesh

Një dietë me pak karbohidrate, mund të ndihmojë në mbajtjen nën kontroll të nivelit të sheqerit në gjak dhe insulinës, të cilat mund të mbrojnë nga diabeti.

Përdorni një dietë me fibra

Konsumimi i një diete të pasur me fibra në çdo vakt mund të ndihmojë në parandalimin e rritjes së nivelit të sheqerit në gjak e të insulinës, të cilat mund të ndihmojnë në uljen e rrezikut për zhvillimin e diabetit.

Merrni vitaminë D

Konsumimi i ushqimeve që përmbajnë vitaminë D ose marrja e shtojcave mund të ndihmojë në uljen e riskut për tu prekur nga diabeti.

Minimizoni ushqimet e përpunuara

Minimizimi i ushqimeve të përpunuara dhe konsumimi i të gjithë ushqimeve me efekte mbrojtëse ndaj shëndetit mund të ndihmojë në uljen e rrezikut ndaj diabetit.

Ushqimet që përmbajnë sheqer mund të vënë në rrezik individët për zhvillimin e diabetit pasi rriten nivelet e sheqerit në gjak dhe të insulinës. Shmangia e këtyre ushqimeve mund të ndihmojë në uljen e rrezikut tuaj.

zhvillimit të diabetit. Humbja e peshës mund të ulë ndjeshëm rrezikun e diabetit.

Ndërrpini duhanin

Pirja e duhanit është e

Pini sa më shumë ujë

mërinë e insulinës, të cilat mund të ndihmojnë në parandalimin e progresit nga prediabet në diabet.

Pirja e ujit në vend të pijeve të tjera mund të ndihmojë kontrollin e nivelit të sheqerit në gjak dhe insulinës, duke ulur kështu rrezikun e diabetit.

Nëse jeni mbipeshë, dobësohuni

Mbajtja e peshës së tepërt, sidomos në zonën e barkut, rrit gjasat e

Minimizoni sasinë e sheqerit në dietën tuaj

Ushqimet që përmbajnë sheqer mund të vënë në rrezik individët për zhvillimin e diabetit pasi rriten nivelet e sheqerit në gjak dhe të insulinës. Shmangia e këtyre ushqimeve mund të ndihmojë në uljen e rrezikut tuaj.

Ushtroni aktivitet fizik

Kryerja e aktivitetit fizik në mënyrë të rregullt mund të rrisë sekrecionet dhe ndjesh-



lidhur fort me rrezikun e diabetit, veçanërisht në duhanpirësit e rëndë. Ndalimi i tij ka treguar që ky rrezik mund të zvogëlohet me kalimin e kohës.

Pirja e kafes ose çajit mund të ndihmojë në uljen e nivelit të sheqerit në gjak, rritjen e ndjeshmërisë së insulinës dhe zvogëlimin e rrezikut të diabetit.

Pini kafe ose çaj

Këshilla

Pini çaj mali për uljen e tensionit të gjakut

Çaji shqiptar i malit përtohet nga gjethet e bimës së varetit Sideritis Raeseri. Ky çaj bimor i maleve të Shqipërisë është konsumuar prej shekujsh falë vlerave të tij shëndetësore. Çaji i malit i varietetit bimor Sideritis Raeseri është natyrisht pa kafeinë. Ai bëhet nga gjethet, lulet dhe kërcëjtë e bimës Sideritis që lulëzon në sapatet dhe malet e vendit tone. Çaji ndihmon me shëndetin e aparatit tretës dhe përmban antioksidantë natyralë. Studiuesit zbuluan se bimët e familjes Sideritis përmbanin substanca të rëndësishme që luftonin mikrobet dhe inflamacionin. Të gjitha këto bimë përmbanin vajra esenciale.

Ul tensionin e gjakut

Një studim i fundit zbuloi se ekstraktet që vinin nga familja e bimëve Sideritis ulnin nivelet e tensionit të gjakut dhe qetësonin



enët e gjakut. Studimi i kryer mbi kalshët nxori në pah se doza domethënëse të ekstrakteve në fjalë ndihmonin në zgjerimin e enëve të gjakut, uljen e tensionit të gjakut dhe uljen e presionit ndaj zemrës. Studimet, gjithashtu, konfirmuan rolin pozitiv të këtyre bimëve për shëndetin e zemrës.

Mbron sistemin tretës

Studiuesit zbuluan se pirja e çajit të malit nga bima e Sideritis ulte inflamacionin në sistemin tretës. Kjo ndodh falë pranisë së fenolëve dhe antioksidantëve që gjenden natyrisht në këto bimë. Studiuesit zbuluan, gjithashtu, se inflamacioni dhe toksiciteti uleshin për një periudhë afatgjatë. Kjo si pasojë e aftësive mbrojtëse të çajit shqiptar të malit.



Konsumoni brokoli për një stomak të shëndetshëm

Studimet tregojnë se brokoli është shumë i shëndetshëm pasi përmban antioksidantë kundër qelizave të dëmshme. Së fundmi, një studim tjetër ka konfirmuar se brokoli i bën shumë mirë shëndetin të stomakut. Ekspertët zbuluan se personat që konsumuan brokoli e përballuan tretjen me më shumë sukses në krahasim me personat e tjerë që ishin subjekt i një regjimi ushqimor pa brokoli. Përfshirja e perimeve si brokoli në dietat ushqimore, arrijnë të aktivizojnë receptorë të rëndësishëm në stomak. Këta receptorë ndihmojnë në mirëmbajtjen e homostazës së stomakut. Njerëzit duhet të konsumojnë të paktën 3 filxhanë e gjysmë me brokoli në javë. Gjetjet tregojnë se brokoli luan një rol parandalues kundër inflamacionit të zorrëve apo koltitit.

Brokoli përmban nivele të larta të kalciumit dhe vitaminës K, të cilat janë të rëndësishme për shëndetin e kockave dhe parandalimin e osteoporozës. Kjo perime e gjelbër bën mrekullira për zemrën. Vlerat anti-inflamatore të brokolit e bëjnë atë të rëndësishëm për mbrojtjen e enëve të gjakut nga problemet që shkaktohen nga sëmundjet kronike që kanë lidhje me sheqerin e gjakut. Brokoli gjatë gatimit duhet të gatuhet sa më pak, në mënyrë që të maksimizohet potenciali i tij ushqyes. Mjafton ta gatuar për një kohë shumë të shkurtër me avull. Prezantimi i fëmijëve me brokolin nuk është një mision aq i pamundur, nëse dini se si t'ua shërbeni. Duke qenë se procesi i gatimit shkatërron disa prej ushqyesve që gjenden te kjo perime, përpiquni ta shkurtoni sa më shumë kohën e gatimit.



Qytetarët duhet të paraqiten pranë zyrave për të tërhequr dokumentin

ALUIZNI / 152 personat që marrin lejen e legalizimit në Pogradec dhe Korçë

Si bëhet rregjistrimi i objekteve me më shumë se 1 pronar

ALUIZNI ka publikuar listën me 152 personat, të cilët kanë gati lejet e legalizimit dhe që do të duhet t'i tërheqin pranë zyrave të ALUIZNI-t në Pogradec dhe në Korçë. Drejtorja e ALUIZNI-t bën me dije se qytetarët duhet të paraqiten pranë zyrave të ALUIZNI-t në Pogradec dhe në Korçë të tërhequr lejen ndërtimore. Ndërkohë që procedurat për marrjen e



tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë. Sipas ligjit në fuqi, kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon objektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve

takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve, lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

LISTA ME PERSONAT QË MARRIN LEJEN E LEGALIZIMIT NË POGRADEC DHE KORÇË

Nr	Emer	Atesi	Mbiemer				
1	Esmat Rakip Elezi			Pogradec	51	Genci Hamdi Pengu	Pogradec
2	Hysen Riza Dullallari			Pogradec	52	Nermin Nezhdet Ibi	Pogradec
3	Jani Llazi Milo			Pogradec	53	Martin Adriatik Jaçe	Pogradec
4	Gavrosh Engjell Maçolli			Pogradec	54	Fatjon Bexhet Muçelli	Pogradec
5	Dorin Durim Elmasllari			Pogradec	55	Gazmir Guri Beshello	Pogradec
6	Haki Lytifi Spaho			Pogradec	56	Ylli Bido Xhydollari	Pogradec
7	Klajdi Resmi Mimini			Pogradec	57	Gezim Zalo Vellillari	Pogradec
8	Kristo Jorgo Samaras			Pogradec	58	Jorgo Pellumb Shkullaku	Pogradec
9	Agim Sherif Dervishi			Pogradec	59	Telha Bari Kasmollari	Pogradec
10	Kristaq Mihal Bozda			Pogradec	60	Gani Servet Jolla+Bp	Pogradec
11	Esat Nazmi Mulla			Pogradec	61	Kalem Dajlan Topalli	Pogradec
12	Mehmet Haxhi Hoxhaj			Korçë	62	Ramadan Beqir Hysen+Bp	Pogradec
13	Gjergji Ali Osmani			Korçë	63	Rexhep Samit Yzellari	Pogradec
14	Arben Ferik Bektasha			Pogradec	64	Xhemil Sali Mislui	Pogradec
15	Haki Bajram Poçka			Pogradec	65	Ferdinant Skneider Myftari	Pogradec
16	Selman Lamçe Basholli			Pogradec	66	Demire File Prifti	Pogradec
17	Nikolla Thanas Çekani			Pogradec	67	Vangjel Myftar Gjata	Pogradec
18	Altin Durim Elmasllari +Bp			Pogradec	68	Perparim Zenel Shuli	Pogradec
19	Famir Lytifi Mançellari			Pogradec	69	Vasil Zisi Simaku	Pogradec
20	Eqerem Kasem Hamzallari			Pogradec	70	Seit Shyqyri Kerellari	Pogradec
21	Kristo Shefki Fqasko			Korçë	71	Perparim Xhevit Shuli	Pogradec
22	Arjan Qazim Alimadhi			Korçë	72	Vangjel Faik Koliçi	Pogradec
23	Manek Nevruz Qazimllari			Korçë	73	Klodjan Zini Lico	Pogradec
24	Ardian Shyqyri Shkembi			Korçë	74	Çlirim Beqir Selmani	Pogradec
25	Petro Seit Llomi			Korçë	75	Rruzdi Hariz Molla	Pogradec
26	Enver Ferit Çicka			Korçë	76	Durim Arefi Xhukellari	Pogradec
27	Selfo Maliq Sulka			Korçë	77	Refat Shefqet Çoçka	Pogradec
28	Isuf Rami Dalip			Korçë	78	Garip Jaup Frahollari	Pogradec
29	Sali Hysen Hysen			Korçë	79	Bariq Fazli Topllari	Pogradec
30	Fatbardha Shaban Shkembi			Korçë	80	Durim Hekuran Bako	Pogradec
31	Adem Idris Manka			Korçë	81	Nikolla Bedo Meruko	Pogradec
32	Bajram Hysen Xhafer			Korçë	82	Dashnor Bashkim Lamlli	Pogradec
33	Agim Qani Kacos			Korçë	83	Gramos Dervishali Beshello +Bp	Pogradec
34	Orion Flamur Shuli			Korçë	84	Flamur Çelnic Merollari	Pogradec
35	Andrea Sami Xhihani			Korçë	85	Adlir Avni Myrte+Bp	Pogradec
36	Rajmon Bari Dullallari			Korçë	86	Edmond Lytifi Bardh +Bp	Pogradec
37	Stavri Musa Vasili			Korçë	87	Lirije Ramadan Lamlli	Pogradec
38	Reshat Hasan Ademaj			Pogradec	88	Bashkim Seit Xhuti	Pogradec
39	Ridvan Sinan Hamzallari			Pogradec	89	Çlirim Guri Beshello	Pogradec
40	Jani Ymer Mani			Pogradec	90	Kujtim Guri Zeka	Pogradec
41	Artan Qerim Bajrami			Pogradec	91	Vasfi Njazi Topalli	Pogradec
42	Safet Muharem Liçko			Pogradec	92	Hasan Nevruz Hoxha	Pogradec
43	Petrit Hariz Molla			Pogradec	93	Medi Nijas Xhika	Pogradec
44	Bujar Feta Ahmetaj			Pogradec	94	Andrea Çelnic Boçka	Pogradec
45	Lirim Seit Ibi			Pogradec	95	Shkelqim Nevruz Latifllari	Pogradec
46	Agim Bujar Pere			Pogradec	96	Medine Veli Topuzi	Pogradec
47	Lefter Naumçe Gegprifti			Pogradec	97	Isuf Qani Dervishllari	Pogradec
48	Bedri Nuri Agolli			Pogradec	98	Muharem Rasim Hoxhallari	Pogradec
49	Pandi Loni Buzo			Pogradec	99	Fatjon Xhevatkastiroti +Bp	Pogradec
50	Gentian Nevruz Cake			Pogradec	100	Petro Niko Zaçellari	Pogradec
					101	Anesti Mehmet Muçllari	Pogradec
					102	Salltem Zani Hamzallari	Pogradec
					103	Dylber Dilaver Hykellari	Pogradec
					104	Mersin Ibrahim Çollaku	Pogradec
					105	Festim Ikbal Abasllari	Pogradec
					106	Çelnic Kurti Mimini	Pogradec
					107	Myrteza Bektash Jasharllari	Pogradec
					108	Bujar Mehmet Mukollari	Pogradec
					109	Eneida Astrit Xhaferaj	Pogradec
					110	Guri Rexhep Meko	Pogradec
					111	Zamir Haki Kapa	Pogradec
					112	Naile Selman Muço	Pogradec
					113	Bajram Pelivan Mimini	Pogradec
					114	Stois Agron Papuli	Korçë
					115	Rahmi Sami Uçi	Korçë
					116	Sekender Bektash Armata	Korçë
					117	Gurali Faik Karanxhaj	Korçë
					118	Vasil Abas Pelo	Korçë
					119	Petro Ruzhdi Cenolli	Korçë
					120	Besnik Xhevair Myrtollari	Korçë
					121	Çlirim Gani Firanj	Korçë
					122	Gjergji Vasil Renja	Korçë
					123	Bibil Ahmet Veliu	Korçë
					124	Sotir Koço Dimushi	Korçë
					125	Maksi Miti Qirici	Korçë
					126	Alfred Selami Xhambazi	Korçë
					127	Albert Selim Zhilla	Korçë
					128	Mariel Zija Durollari	Korçë
					129	Adnand Muhamet Xhuli	Korçë
					130	Piro Xhuvri Postoli	Korçë
					131	Anesti Fejzo Zezollari	Korçë
					132	Gjergji Leko Qiska	Korçë
					133	Flori Vasfi Muçllari	Korçë
					134	Spartak Nevruz Veis	Korçë
					135	Kosta Haqif Hoxhallari	Korçë
					136	Shpetim Seladin Agolli	Korçë
					137	Tatjana Orhan Xhafer	Korçë
					138	Kostaq Koli Gjeli	Pogradec
					139	Vladimir Kosta Kiço	Korçë
					140	Jani Stavri Dajko	Korçë
					141	Mustret Halil Piliñi	Korçë
					142	Arben Xhevair Ziso	Korçë
					143	Hetem Pasho Sulollari	Korçë
					144	Vasil Beqir Hamati	Pogradec
					145	Leonidha Beqir Hamati	Pogradec
					146	Refat Baki Agolli	Korçë
					147	Fejzi Petrit Plepi	Korçë
					148	Fevri Baki Agolli	Korçë
					149	Bexht Neki Kapo	Korçë
					150	Hysen Niazi Fejzollari	Korçë
					151	Valter Rasim Qazolli	Korçë
					152	Skender Hajder Shaholli	Korçë

RRËFEHET PIKTORI: POGRADECI ËSHTË NGACMIMI KRYESOR NË FORMIMIN E PALETIT TIM



Mandi Xhika: Njëpërmjet penelitet shoh dhe njoh botën, aty e gjej dhe humbas veten

Egla Xhemali

Arti për të është mënyrë e të jetuarit, pasioni dhe bashkudhëtari i ciklit të tij si piktor. Mandi Xhika në një intervistë për "Gazeta shqiptare" na tregon për hapat e parë të pasionit të tij të hershëm që më pas do të kthehej në profesionin dhe pasionin e tij më të madh. Për të, arti është një mënyrë dhe eksperiencë e të kuptuarit të botës. "Njëpërmjet tij ne lejojmë të tjerët të shohin diçka të ne, të cilën as vetë nuk e shohim dot", shprehet artisti. Ai thotë se nuk ka një stil të caktuar që e ndjek, por i pëlqen të eksperimentoj me ngjyrën dhe formën në pikturë. I pyetur se sa e ka frymëzuar vendlindja, Pogradeci në koloritin e tablove, Xhika pohon se për të është ngacmimi kryesor në formimin e paletit. Piktori rrefen se është paqësor sa ç'është dhe agresiv në ngjyrë dhe formë, ashtu siç është dhe ligëni. Ai jeton çdo ditë me natyrën e Pogradecit. I pëlqen kompozimi, po ashtu natyra dhe peiza. Artisti dhe piktori surrealist, Dali, ka ndikuar për një kohë relativisht të gjatë të pikturave të Xhikës, por ai është gjithmonë në kërkim të risive dhe kështu do që të jetë dhe arti i tij. Artisti na njeh me kujtimet e janarit të 2017, vit në të cilin ka marrë pjesë me katër punë dhe ka fituar çmimin e tretë në ekspozitën "Ngjyrat e familjes sime". Po ashtu ai na zbulon se ka marrë pjesë në pesë ekspozita të zhvilluara në Angli, konkretisht në Liverpool dhe Southport, si dhe ka ekspozuar pikturën në galeri të ndryshme në to. Për të arti pa emocion s'ka kuptim. Jeta është aq e fuqishme dhe kontradiktore sa krijon dhe na ngarkon me shumë energji pozitive dhe negative. Piktorët sipas tij kanë fatin që këto energji t'i hedhin në telajo, në ngjyra, forma dhe perceptime artistike. Të jetuarit në Liverpool, natyra, arkitektura e ndërtesave janë indicë për punën e tij artistike. Xhika pohon se Ermira Babaliju, këngëtarja e mirënjohur dhe njëkohësisht motra e tij ka qenë e para që e ka inkurajuar në rrugën e artit. Ai është rritur me muzikën dhe këngët e saj e thotë se është me fat që e ka motër. Së fundmi, piktori na tregon për dëshirën e hapjes së një ekspozite personale në Liverpool dhe në Tiranë. Xhika beson se vitin tjetër do t'i realizojë të dyja.

Si ka nisur pasioni juaj për pikturën?

Pasioni për pikturën është i hershëm. Diku andej nga fillorja kam kuptuar se më pëlqente piktura. Pas shkolle shkjoja në kurset e pikturës në shtëpinë e pionierit. Kam pasur fatin që mësuës vizatimi kam pasur piktorin e njohur Skënder Lako, i cili më ka ndihmuar në fillimet e mia. Pastaj vazhdova liceun artistik në Korçë. Këtu jam fillimet e mia.

Ç'është arti për ju?

Arti për mua është një mënyrë e të shprehurit që shkon përtej imagjinatës. Aty e gjej dhe e humbas vetveten njëkohësisht. Arti është një mënyrë dhe eksperiencë e të kuptuarit të botës. Njëpërmjet tij ne lejojmë të tjerët të shohin diçka të ne, të cilën as vetë nuk e shohim dot.



Në cilin stil punoni dhe kujt rryme i përkë?

Nuk mund të them se kam një stil të caktuar në punët e mia. Në të shumtën e rasteve eksperimentoj me ngjyrën dhe formën pa ndjekur një stil apo një tjetër. Më pëlqen surrealizmi, por dhe ekspresionizmi. Punoj më shumë me vaj dhe bojëra uji.

Sa ju ka frymëzuar Pogradeci në koloritin e tablove?

Pogradeci me atë natyrë dhe atë liqen ka frymëzuar shumë piktorë dhe poetë të flasin me gjuhën e penelitet ose të penës. Është ngacmimi kryesor në formimin e paletit tim. Shumë herë jam paqësor sa ç'jam dhe agresiv në ngjyrë dhe formë, ashtu siç është dhe ligëni. Jetoj çdo ditë me natyrën e Pogradecit (nëpërmjet fotove) dhe është e çuditshme se çdo ditë më ngacmon në mënyrë të ndryshme.

Në cilat galeri i keni ekspozuar punimet tuaja?

Kam ekspozuar në Muzeun Kombëtar në 2013. Në janar të 2017 në ekspozitën "Ngjyrat e familjes time" kam marrë pjesë me katër punë dhe kam fituar çmimin e tretë. Njëkohësisht kam marrë pjesë në pesë ekspozita të zhvilluara në Angli. Konkretisht në Liverpool dhe Southport. Si dhe kam ekspozuar pikturën në galeri të ndryshme në Liverpool. Gjithashtu, kam marrë pjesë në ekspozita ndërkombëtare që zhvillohen online ku dhe kam marrë certifikata mirënjohje dhe çmime të ndryshme.

Jam gjithmonë në kërkim të risive, kështu dua të jetë dhe arti im

Çfarë ju pëlqen më shumë të pikturoni?

Varet nga gjendja shpirtërore. Por kam vënë re se në periudha të ndryshme kohore kam pasur preferencë të ndryshme për ato që kam pikturuar. Më pëlqen kompozimi ashtu siç më pëlqen dhe natyra, peiza. Shumë herë puna ka marrë rrjedhë të ndryshme nga ato që kam menduar në fillim dhe kjo i shtryr nga momenti i ngjyra ose forma e diçkaje. Kjo është e veçantë, sepse kuptoj që kam udhëtuar në mendimin tim pa e menduar. Në fund shoh të shkuarën të transformuar në të ardhmen. Dhe me ndodh shpesh.

Kush nga artistët botërorë apo rrymë, ka ndikuar në krijimtari?

Për një periudhë të gjatë më ka pëlqyer Dali, por siç thashë tani vonë më pëlqen të eksperimentoj me format dhe mënyrat e hedhjes të pikturave në telajo, kështu që nuk mund të them se kam më preferencë për një piktor të caktuar. Bota ka aq shumë piktorë dhe rryma sa mund ta gesh veten në shumë prej tyre pa e kuptuar. Mua kjo më pëlqen. Jam gjithmonë në kërkim dhe kështu dua të jetë dhe arti im.

Në cilat galeri i keni ekspozuar punimet tuaja?

Kam ekspozuar në Muzeun Kombëtar në 2013. Në janar të 2017 në ekspozitën "Ngjyrat e familjes time" kam marrë pjesë me katër punë dhe kam fituar çmimin e tretë. Njëkohësisht kam marrë pjesë në pesë ekspozita të zhvilluara në Angli. Konkretisht në Liverpool dhe Southport. Si dhe kam ekspozuar pikturën në galeri të ndryshme në Liverpool. Gjithashtu, kam marrë pjesë në ekspozita ndërkombëtare që zhvillohen online ku dhe kam marrë certifikata mirënjohje dhe çmime të ndryshme.

hje dhe çmime të ndryshme. Sa ndikon gjendja emocionale në momentin kur i drejtoheni telajos?

Asnjëherë nuk kam filluar ndonjë punë në telajo apo letër pa qenë i ngarkuar emocionalisht. Për mua është i domosdoshëm ana emocionale. Ka momente kur rri me ditë të tëra ose javë pa punuar. Por, vjen një moment kur më shkund dhe e ndjej që është koha për të filluar përsëri. Arti pa emocion s'ka kuptim. Jeta është aq e fuqishme dhe kontradiktore sa krijon dhe na ngarkon me shumë energji pozitive dhe negative. Ne piktorët kemi fatin që këto energji t'i hedhim në telajo në ngjyra, forma dhe perceptime artistike.

Ju aktualisht jetoni në Angli. Sa ju ka ndihmuar të qenit atje në lidhje me artin tuaj?

Unë momentalisht jetoj në Southport në Mbretërinë e Bashkuar. Është një qytet bregdetar i bukur, afër Liverpoolit. Ka shumë duna dhe brigje deti të bukura. Natyra është ajo që më ka ngacmuar kryesisht këtu. Ka lëvizje të fuqishme të motit nga dielli i fuqishëm në zymtësi dhe shi, ka qetësi dhe furtuna me ditë të tëra. Është një trokitje e përditshme në brendësi, të cilën nuk mund të rri dot pa e hedhur në pikturë. Pastaj është dhe ana e infrastrukturës. Një Liverpool i jashtëzakonshëm me ndërtesa të mahnitshme arkitekturore dhe muze pafund. Të gjitha këto janë indicë në punën time artistike.

Ju jeni familje artistësh, pasi këngëtarja e mirënjohur Ermira Babaliju është motra juaj. Çfarë raportesh keni me të dhe sa tishytë të ka dhënë ajo në pikturë?

Mund të them që Mira ka qenë e para që më ka inkurajuar në rrugën e artit. Që i vogël jam rritur me muzikën dhe këngët e Mirës. Qysh atëherë ka qenë dhe është bashkudhëtare me mua në rrugën e artit. Jam me fat që kam një motër si Mira.

Keni menduar ndonjëherë të hiqni dorë nga pasioni juaj më i madh? Nëse po, cila do ishte arsyeja?

As nuk më ka shkuar ndonjëherë nëpër mendje. Kam pasur periudha kur dhe s'kam punuar, por ato kanë qenë periudha mbushje dhe akumulimi për t'u kthyer në pikturë me më shumë fuqi dhe ekspresivitet. Por, që ta lë pikturën, as që e mendoj.

Cilat janë planet tuaja më të afërta? Keni dëshirë t'i ekspozoni pikturat tuaja në Shqipëri?

Kam shumë dëshirë të hap një ekspozitë personale këtu në Liverpool. Dhe dëshira tjetër është hapja e një ekspozite personale në Tiranë. Mendoj se ka ardhur koha për mua ta bëj një gjë të tillë. Besoj se vitin tjetër do t'i realizoj të dyja.



Opinion **i** Ditës

Shtatorja e Azemit i tremb bijtë e etërve, të cilët ai i rrëzoi 26 vjet me parë

Nga Belind Këlliçi

(Vijon nga faqja e parë)

... e vështirë t'i shpjegosh. Ceremonia e së premtes ishte kthyer në temë diskutimi në çdo tavolinë demokratësh dhe jo vetëm. Kur do nisesh për në Tropojë? Me kë do të shkosh? Ikim bashkë? Ata që patën fatin ta njohin tregonin pjesëza të historisë me të.

Natyrisht me shumë gëzim dhe me një krenari të ligshme flisnin bashkëqytetarët e tij. Dukej se kishte kohë që pritej rikthimi i Azemit në shtëpi. Dita po vinte, emocionet po shtoheshin. Tropoja ka qenë e vijon të mbetet një frymëzim i madh për çdo demokrat. Qyteti që i dha dy bijtë të çmuar lëvizjes për demokraci dhe arkitektin e zhvillimeve të rëndësishme të Shqipërisë sot, Azem Hajdarin dhe Sali Berishën. Tropoja u kthye, po ashtu, në shtëpinë apo konakun, siç e quajti Daut Haradinaj, të UCK, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mëngjesin e së premtes herët u nisëm për në Tropojë. Falë kontributit të Azem Hajdarit, punës dhe përkushtimit të Sali Berishës, vizionit dhe luftës së Ibrahim Rugovës e Adem Jasharit dhe shumë luftëtarëve të UCK, rruga ishte ndër më të bukura dhe emocionueset që jo me shumë se 10 vite më parë askush s'do ta kishte imagjinuar. Kaluam përmes rrugës së kombit, për t'u ndalur për një kafë në Gjakovë e me pas ndaluan në sheshin qendror të Bajram Currit. Malësia e Gjakovës siç u pëlqen ta thërresin tropojanët, priste shumë miq. Qyteti ishte në festë. Shtatlatrë e me krenarinë që karakterizon çdo qytetar që të takonte, të uronin mirëseardhjen në qytetin e Azemit dhe Sali Berishës. Një qytet i vogël që i ka dhënë kaq shumë historisë së Shqipërisë. Kënga e vallja ofshëntin në qytetin mes malesh. Të ftuarit nga çdo trevë shqiptare po zinin vend. Miqtë mes të cilëve kryetarit i Partisë Demokratike Lulzim Basha dhe ish-kryeministri Sali Berisha, zbuluan shtatorin e Azemit. Krenar me gjoksin përballë furtunës e me shikimin që përfshinte çdo trevë shqiptare, qëndronte Azemi në mes të qytetit të tij. Shtatullat ia mbronte mali i Shkëlzenit e përballë kishte miq të vjetër e të rinj, bashkëluftëtarë e mijëra qytetarë që kishin dalë për t'i uruar mirëseardhjen.

Teksa shihja Azemin, në mendje më vinte gjithçka lidhje me vitet e lëvizjes studentore të viteve '90. Një i ri që vinte nga qyteti më i largët, guxoi të vihej përballë një regjimi ndër më kriminalët në Europë. Një guxim për t'u adhuruar dhe një mesazh i madh për mua dhe bashkëmoshatarët e mi. Ceremonia mbaroi, por jehona vazhdon akoma. Një energji pozitive na sho-



qëron nga qyteti i vogël verior, një frymëzim i madh nga vepra e Azem Hajdarit. Azemi na u rishfaq sot dhe si një apel në këto kohë të zeza që po kalon vendi për t'u ngritur dhe për ta shpëtuar Shqipërinë nga kthetrat e krimit ku ka rënë. Mediat gjerësisht flisnin për guximin e Azemit. Një guxim që dhe sot ende frikëson bijtë e etërve që u rrëzuan në vitet '90. Hija e tij i ndjek nga pas.

Heronjtë kanë aftësinë të kalin tmerr dhe më përmendoret e urryera komuniste. Nga ylli i kuq, të fotoja e diktatorit Hoxha, nga promovimi në poste të larta i funksionarëve të regjimit dhe bijtë e tyre, të dekorimi i xhelatëve të diktaturës. Mercenarë të qeverisë nxituan të villnin vrer ndaj figurës së Azemit. Nuk bënë asgjë më shumë veçse reflektuan frikën e tyre të guxi-

mi, frymëzimi dhe motivimi që Azemi u bën të rinjve sot. Teksa lexoja disa prej tyre që simbolizojnë aleancën e qelbësirave, ndjeja keqardhje në batakun ku kanë rënë. E me shumë keqardhje ndjej për bashkëmoshatarët e mi Ramistë (jam i bindur që socialistët e vërtetë s'kanë asgjë të përbashkët me të rinjtë adhurues të Ramës).

Rilindja u ka dhënë si model trafikantët, përdhunuesit, kriminelët. Modeli i tyre i demokracisë janë qeveritarët e lidhur me krimin dhe trafiket, si ish-ministri Saimir Tahiri apo ministri aktual Fatmir Xhafaj. Modeli i tyre për të ecur përpara në jetë e për të qenë i suksesshëm është Arben Ndoka, Mark Frroku, Armando Prenga, Elvis Roshi, Artur Bushi, etj. Modeli i tyre është se në pushtet vihet duke blerë vota në bashkëpunim me krimin, se si qeveria vihet në shërbim të trafikantëve. Modeli që u ofrohet është

kanabizimi i Shqipërisë. Modeli i zhvillimit që u serviret është punësimi në arat e kanabisit.

Unë e kuptoj Ramën dhe mercenarët e tij që s'mund të vlerësojnë dot figurën e Azemit, sepse frymëzimi i tyre është Enver Hoxha, janë Ndokët, Bushët, Roshët, Habilajt, Balilajt, e çdo kriminel e trafikant i mundshëm. Mos i paragjykoni se gjithkush ka modelin e tij në jetë. Demokratët kanë Azemin, kanë Sali Berishën, Gramoz Pashkon, Pjetër Arbnorin e shumë të tjerë. Unë s'pata fatin ta njoh Azemin, por sot shpirtin e tij luftarak, guximin e pasohoj dhe dëshirën për një Shqipëri europiane, e shoh të çdo bashkëmoshatarë që do një Shqipëri pa krim, pa drogë, të zhvilluar dhe europiane.

Azemin nuk e kam njohur, por ai është frymëzim për mua se si një i ri duhet të guxojë dhe luftojë për liri dhe demokraci, për idealin dhe ëndrrat e tij.

HOROSKOPI

DASHI

Vendosni për iniciativat që do ndërmerri dhe mos u shqetësoni nëse nuk përshatëni me pritshmëritë e të tjerëve. Ngjehuni të lirë. Mos i lëndoni njerëzit që ju duan të mirën. Jeni më të vëmendshëm dhe të ndjeshëm ndaj dëshirave të personave të tjerë.

DEMI

Të orientuar nga Mërkuri të Shigjetari, rrezikoni të flitni shumë dhe pa lidhje. Kini kujdes nëse nuk dëshironi të shkatërroni momentet magjike me partnerin. Nëse keni vendosur të merreni me sport, zgjidhni një aktivitet që mund ta praktikoni në ajër të pastër.

BINJAKET

Nën qotidjen e Hënës ngacmuese të Peshqit, kjo e hënë do kalojë mes lufatëve të humorit. Keqkuptime në familje për çështje të parëndësishme. Një sforcim i madh është i nevojshëm në çift për të kuptuar plotësisht nevojat e njëri-tjetrit.

GAFORJA

Më në fund një ditë e gëzuar dhe e lehtë, falë Hënës mike të Peshqit. Do merrni sqarime, shkëmbime mendimesh dhe vendime të rëndësishme për ju. Në punë edhe sot do jepni më të mirën e mundshme dhe do vlerësoheni për inteligjencën tuaj.

LUANI

Duhet të zgjidhni midis rrugës së vjetër dhe asaj të re. Urani i prirur nga Dashi do t'ju ndihmojë për t'u orientuar dhe për të arritur atë që duhet. Mos i neglizhoni këshillat e vlefshme të një kolegu pasi do jenë të dobishme për të arritur një objektiv të rëndësishëm.

VIRGJERESHA

Jeni në kërkim të një pune të re? Do merrni propozime të ndryshme. Megjithatë para se të pranoni, analizoni avantazhet dhe disavantazhet. Përshatuni me rregulla të shëndetshme jetese. Duhet të ulni në mënyrë drastike angazhimet e tepërta.

PESHORJA

Jepni më të mirën e mundshme. Duke pasur parasysh simplicitetin dhe simpainë tuaj, personi që ju ka për zemër sigurisht që do të kapitulojë. Plutoni nuk është në harmoni me shenjë tuaj, në punë do jetë mirë të rini larg lojërave të pushtetit. Tregohuni neutral.

AKREPI

Mbështetja e Hënës që i buzëqesh Jupiterit dhe Diellit në bashkëpunim, do t'ju bëjë të kuptoni atë që është e rëndësishme në jetën tuaj dhe atë që nuk është. Me Jupiterin që kalon në shenjë tuaj, do arrini një fitore ligjore për të cilën i kishit humbur shpresat.

SHIGJETARI

Ankthi dhe nervozizmi nuk zhduken me një gjest të thjeshtë vullneti, do isdo më mirë të mësoni si të ndani gjërat me të tjerët. Vendosni të ndiqni një dietë të shëndetshme, të pasur me shumëllojshmëri ushqimesh, por jo shumë sasi.

BRICJAPI

Mercuri aleat do ju ndihmojë të përballon argumente të komplikuar, edhe jashtë njohjeve tuaja. Jeni këshilla të vlefshme miqve tuaj. Në çift kini kujdes me sjelljen tuaj pak arrogante, nganjëherë duhet të dëgjoni edhe të tjerët.

UJORI

Keni një pikëpamje të qartë të situatës profesionale aktuale dhe zhvillimeve të mundshme në të ardhmen, gjë që do t'ju japë avantazh ndaj konkurrentëve tuaj. Mos u alarmoni ndaj mosmarëveshjeve burokratike. Bëhet fjalë për gjëra të vogla që do zgjidhen shpejt.

PESHQIT

Hëna bashkëpunuese në qielin tuaj e mbështetur nga Jupiteri dhe Dielli do ju japë mundësinë të modifikoni gjithçka që nuk ju bind. Përpiguni të jeni më konkret nëse nuk doni të humbisni mbështetjen e personave me të cilët mund të arrini gjëra të mëdha.

Katouica

Shqetësimi amerikan për modelin serb të "dy karrigeve"

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Derisa SHBA vë në dyshim orientimin european të Serbisë, Shqipëria duhet ta ketë dy herë më të madh dyshimin.



... të dashurisë edhe me BE, edhe me Rusinë. Në datën 23 tetor në Beograd zëvendësndihmës sekretari amerikan i shtetit për çështjet europiane, Hoyt Bryan Yee, në samitin ekonomik serb në mënyrë publike, dhe në datën 24 tetor në bisedimet zyrtare me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, shprehu me forcë qëndrimin e SHBA se "Serbia nuk mund të rrijë me një këmbë në rrugën drejt BE dhe me këmbën tjetër në aleancën me Rusinë. Serbia nuk mund të rrijë në dy karrige". Është një mesazh i fortë zyrtar, i cili ka rëndësi të veçantë në raportet dhe në politikën e jashtme të Serbisë ndaj BE, ndaj Rusisë dhe ndaj rajonit.

Hapi i fortë amerikan tregon se Serbia e ka mbushur kupën dhe se ka ardhur koha që Perëndimi t'i vendosë asaj pike-ta të qarta se në cilin drejtim strategjik do të shkojë. Vrapit i qeverisë dhe i diplomacisë serbe drejt aleancës dhe lidhjeve të posaçme me Rusinë ka shtyrë diplomacinë amerikane të gjykojë se tani duhet folur prerazi me Serbinë. Alibia e çuditshme e diplomacisë europiane se duke toleruar Serbinë të lidhet ngushtë me Rusinë e mbajmë atë larg nga Rusia, nuk shërbeu për asgjë, veçse për të mbuluar nivelet e rrezikshme të aleancës serbo-ruse. Në mënyrë të veçantë loja bizantine e Serbisë, duke forcur aleancën me Rusinë dhe duke u shtirë sikur po shkon në BE, po merr përmasa dëmprurëse për interesat atlantike dhe europiane në Ballkan.

Përfaqësuesi i departamentit të shtetit i paraqiti zyrtarisht presidentit serb shqetësimet amerikane për bazën ushtarake ruse në Nish dhe për projektin qeveritar serb për t'i akorduar imunitet diplomatik personelit ushtarak rus të kësaj baze. Ai i kërkoi presidentit serb të njohë Kosovën dhe të ndërprejë mbështetjen për udhëheqjen separatiste dhe prorusë të ashtuquajturës "serpska republika", dhe në mënyrë të veçantë i tërhoqi vëmendjen presidentit serb se Serbia po luan për interesat e Rusisë në rajon. Kaq e fortë ishte ndërhyrja amerikane lidhur me këtë situatë, sa që presidentin serb në komunikatën e saj të datës 25 tetor për bisedimet Hoyt Brian Yee-Vuçiq theksonte se diplomati amerikan "Shprehu, gjithashtu, shqetësimin për influencën ruse në rajon".

Është e kuptueshme se loja e rrezikshme serbe e "dy karrigeve" i ka shërbyer dhe i shërben strategjisë dhe interesave të ndërhyrjes dhe ndikimit rus në Ballkan dhe jo europianizimit të Serbisë apo përgatitjes së saj për anëtarësim në BE. Serbia po bëhet gjithnjë e më ruse. Ndërhyrja ruse në rajon po forcohet dhe ajo po merr formë gjithnjë e më të sofistikuar. Është një dinamikë negative për të cilën duhet të bëhen të ndërgjegjshme qeveritë dhe diplomatët e vendeve të rajonit dhe të vendeve të tjera europiane. Në datën 20 tetor ministri i Jashtëm të 8 shteteve europiane, të Kroacisë, të Suedisë, të Polonisë, të Britanisë së Madhe, të Letonisë, të Lituanisë, të Çekisë dhe të Rumanisë, i dërguan një letër të përbashkët shefes së politikës së Jashtëm dhe të Sigurisë të BE, Federicca Mogherini, për të ndërmarë masa të forta në përbalimin e propagandës dezinformuese ruse në drejtim të vendeve të BE.

Në Ballkan Serbia është shndërruar në një instrument kryesor të ndërhyrjes ruse në punët e brendshme të vendeve të rajonit dhe për shtrirjen e influencës ruse. Serbia ka zgjedhur të ndjekë dhe të propagandojë modelin e saj të "dy karrigeve" si një rrugë për të realizuar ambicien e saj të hegemonisë në rajon. Realisht Serbia ka qëndruar në karrigen ruse, ndërsa karrigen europiane e ka përdorur dhe e përdor si mbulesë për rusizimin e saj politik, ushtarak dhe gjenetik.

Është e nevojshme të theksohet këtu fakti se një pjesë të fajit për modelin serb të "dy karrigeve" e ka vetë BE. Ne kemi theksuar vazhdimisht ndër vite në analizat tona se BE ka ndjekur një politikë të standardeve të dyfishta për integrimin në Ballkan. Për Serbinë ka bërë lëshime dhe indulgjenca të pajustifikueshme në procesin e integritetit të saj europian. BE i dha Serbisë MSA-në pa plotësuar kriteret, në një kohë që Beogradi ia hodhi poshtë dhe refuzoi ta nënshkruante. BE nuk ka folur asnjë fjalë për ardhjen në pushtet në Beograd të garniturës së Milloseviçit në pesë vitet e fundit. Nuk ka folur për mbrojtjen që Beogradi po i bën kriminelëve ndërkombëtarë të luftës dhe promovimin e tyre shtetëror e zyrtar, duke i emëruar profesorë në Akademinë Ushtarake serbe, veprim që Hoyt Yee e kritikoi ashpër publikisht në Beograd. BE nuk ka folur për bazën ushtarake ruse në Nish të përruar në vitin 2011 dhe as për armatosjen e etnisme që Rusia po i bën Serbisë, ku vetëm në muajin tetor erdhën në Serbi gjashtë avi-

onë gjuajtës MIG-29, dhuratë e Moskës. Nuk ka folur BE as për manovrat e përbashkëta ushtarake ruso-serbe në Serbi dhe përgatitjen e forcave desante ruse për ndërhyrje në Ballkan. Nuk ka folur për blerjet e raketave ruse nga Serbia dhe as për marrjen e statusit të shtetit vëzhgues prej saj në Asambleen Parlamentare të bllokut ushtarak rus CSTO. Nuk ka folur BE për ndërhyrjen e përbashkët dhe organizimin ruso-serb të përpjekjes për grusht shteti në tetor të vitit të kaluar në Mal të Zi dhe as për ndërhyrjen e përbashkët ruso-serbe në krizën politike maqedonase vitin e kaluar. Serbia nuk pati asnjë sanksion nga Brukseli për refuzimin e saj për t'iu bashkuar sanksioneve europiane ndaj Rusisë. Heshjtja e BE përballë shndërrimit të një shteti kandidat, Serbisë, në një instrument të strategjisë antieuroatlantike të Rusisë në Ballkan natyrisht është interpretuar nga Beogradi si leje-kalimi dhe kjo e ka inkurajuar Serbinë në shpejtimin e ritmeve të aleancës së saj me Rusinë.

Loja e rrezikshme serbe e "dy karrigeve" i ka shërbyer dhe i shërben strategjisë dhe interesave të ndërhyrjes dhe ndikimit rus në Ballkan dhe jo europianizimit të Serbisë apo përgatitjes së saj për anëtarësim në BE. Serbia po bëhet gjithnjë e më ruse.

ar nga Beogradi si leje-kalimi dhe kjo e ka inkurajuar Serbinë në shpejtimin e ritmeve të aleancës së saj me Rusinë.

Serbia e mbushi kupën e durimit dhe të kurtëzisë diplomatike të SHBA. Mendimi im është se qëndrimi i fortë i qeverisë amerikane i shprehu nga Hoyt Yee në Beograd mund të lexohet edhe si një vërejtje indirekte për diplomacinë e BE, sidomos për disa segmente të saj, të cilat për arsye të ndryshme janë vetë për politika të buta ndaj Rusisë, pavarësisht nga kriza ukrainase dhe aneksimi i dhunshëm i Krimesë.

Modeli serb i qëndrimit në "dy karrige" është toleruar tet çdo kufiri nga diploma-

cia e BE. Por ai është një model shqetësues diplomatik, sepse pranimi i sindromës së "dy karrigeve" do të thotë që të krijosh precedentin për përhapjen e kësaj sindrome. Nuk është rastësi që modelin e "dy karrigeve" e shohim sot të aplikohet në Hungari, në Sllovakia, në Greqi, në Qipro, etj.

Lëvizja e diplomacisë amerikane në Beograd është një lëvizje e duhur dhe pozitive për gjithë rajonin tonë. Ajo demonstroi jo thjesht shqetësimin, por edhe angazhimin e qeverisë të presidentit Trump për të mos lejuar fragmentarizimin e interesave euroatlantike në Ballkan. Në këto situata bëhet akoma më e rëndësishme për Shqipërinë që të kuptojë thelbin e zhvillimeve dhe të mos bëhet pre e lojërave të fshehta bizantine të Serbisë. Derisa SHBA vë në dyshim orientimin european të Serbisë, Shqipëria duhet ta ketë dy herë më të madh dyshimin. Shqipëria ka një rol të madh për të lozur në mbrojtjen të interesave atlantike dhe europiane në rajonin tonë. Ky rol kërkohet alarmi amerikan për modelin serb të "dy karrigeve" të kthellojë Tiranën për dinamiken reale të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë.

Shteti shqiptar nuk është i imunizuar nga përpjekjet ruse për të neutralizuar Shqipërinë si faktor në rajon. Ka një përputhje interesash strategjike të Rusisë me Serbinë për të mos lënë Shqipërinë dhe Kosovën dhe kombin shqiptar të jenë faktor i interesave perëndimore. Diplomacia ruse dhe serbe janë përpjekur t'i këshillojnë Tiranës dobite e modelit të "dy karrigeve" dhe të krijojnë një marrëdhënie specifike me Moskën.

Në këtë drejtim synon ta drejtojë politikën shqiptare propaganda dhe influenca ideologjike ruse në Shqipëri. Shenjë e hidhur e influencës së lobit rus është fakti që rrjetet mediatike dhe sociale shqiptare e bojkotuan letërnë 8 ministrave të Jashtëm të vendeve të BE për një kundërvënje ndaj dezinformacionit të propagandës ruse. Është identike me çka ndodhi edhe në 23 nëntor 2016 me rezultat në Parlamentin Europian për masat ndaj dëpërimit të propagandës dhe dezinformacionit të propagandës ruse në vendet e Europës dhe të cilën rrjetet mediatike shqiptare e injoruan. Dëshmi e ndikimit dhe e veprimit të lobit rus në Tiranë ishte ai anti-amerikanizëm rural, që u shfaq nga opozita gjatë krizës politike në pranverën e këtij viti dhe ku u arrit deri sa të thirreshin për ndihmë specialiste rusë të trazirave sociale. Këto janë shqiptarë të qarta të sponsorizimit dhe ndikimit të lobit rus, që synon të krijojë klimën e penetrimit rus në Shqipëri. Rusia po tenton të blejë vetë ose përmes një shteti të tretë dy objekte të rëndësishme në Shqipëri, njëri në mes të Tiranës dhe tjetri në mes të detit. Përkrahësit e sponsorizuar shqiptarë të modelit serb të "dy karrigeve" vazhdojnë leksionet për dobite e investimeve dhe të lidhjeve ruse, duke krijuar tym rreth zyrave shtetërore, të cilat për fat të keq i mbajnë afër sirenat serbe dhe ruse. Shqipëria duhet të përcaktojë gartë me kë po bashkëpunon: me Serbinë e Rusisë apo me Serbinë e BE.

Serbia reale është ajo për të cilën shpreh shqetësimin Amerika dhe këtë nuk duhet ta harrojnë për asnjë moment as qeveria, as diplomacia dhe as partitë politike shqiptare.

RIKTHIMI I GJOKËS



Kukësi-Vllaznia dhuroi një shfaqje të bukur të futbollit ofensiv, lumë golash, por asnjë fitues. Ernest Gjoka rikthehet si triumfator në qyteti ku i dhurojnë titullin

e parë historik, ndali verлиндorët pas një ecurie shumë pozitive duke e larguar Kukësin në -5 nga Skënderbeu i vendit të parë. Vllaznia surprizon të zotët e shtëpisë që në minutën e 6-të. Një

Vllaznia ndal Kukësin në "Zeqir Ymeri"

goditje dënimi e ekzekutuar nga Gilman Lika kthehet në kuadrat nga Pjeshka, portieri Koliqi arrin ta devijojë në shtyllën pingule, por topi kthehet në këmbët e Çarlis Atsina, që e ka të lehtë ta dërgojë në rrjetë me portën e boshatisur. Goli i shpejtë përgjum akoma dhe më shumë skuadrën e Kukësit tekta Çinari në minutën e 11-të shkëputet shumë bukur dhe me

një parabolë të ëmbël përpigjet të shënojë golin e dytë por topi shkojë mbi traversë. Të orientuar në fushë, Kukësi lë shumë hapësira pas me Atsinan që i ndëshkon sërish në minutën e 19-të. Sulmuesi i Vllaznisë provoi fillimisht me një goditje të fortë që nuk arrin të kontrollohet nga Koliqi ndërsa Edson Hasani e rikthen sërish në lojë duke i

dhënë mundësinë Atsinës të shënoi golin e dytë personal dhe të dytin për Vllazninë. 0-2 as 20 minutash lojë ishte shumë për një ekip si Kukësi që rikthehet në lojë 5 minuta më pas me një gol të Sidrit Gurit. Sulmuesi shtatëmetë fituan duelin ajrorë me mbrojtësit shkodranë dhe më kokë në shtyllën e parë arrin dërgon topin në rrjetë duke ngushtuar diferencat në 1-2. Kukësi pak nga pak merr kontrollin e lojës dhe në fundin e pjesës së parë ishte Aliev, i cili me kokë flirtojë me golin e barazimit. Pjesa e dytë nisi me një

ritëm të ulët dhe me shumë faulla në mesfushë, por ndeshja ndizet akoma më shumë në minutën e 60-të fal një supergoli të shënuar nga Kale. Fantazisti brazilian me një goditje fantastike nga jashtë zonës rikthehen baraspeshën në stadiumin Zeqir Ymeri. Shtubina i shkojë shumë pranë golit të ishit, por Selmani mbrojtur në lojë pikën e Vllaznisë që sigurisht nuk është për t'u hedhur poshtë e arritur në një fushë si ajo e Kukësit ku vetëm Skënderbeu ka arritur të marrë pikë.

Shënon i zakonshmi Hoxhaj. Partizani humbet kontaktin me pjesën e sipërme të renditjes

Partizani e lë takati, Flamurtari e bën festë

Vlonjatët thyejnë të kuqtë në kryeqytet



Jeton Selimi

Partizani vinte me një moral të lartë në përballjen ndaj Flamurtarit pas tre fitoreve radhazi. Por vlonjatët e Shpëtimit Duros goditën në të vetmin rast të paraqitur dhe më pas arritën të bllokojnë ofensivën e kuqe, që jo rastësisht dështon të finalizojë ndaj ekipeve të pjesës së sipërme të tabelës. Basrak vuan markimin e rreptë të Bicit, ndërsa Trashit në krah e arrin rrallë fundoren, falë taktikës mbrojtëse të Duros, që i heq në maksimum oksigjenin në sulm të kuqve.

Takimi është i fortë, por raste të mira nuk do të ketë (6' gjuan Vila), teksa gjuajtjen e vetme në kuadrat në këtë pjesë loje e bën Flamurtari me Ardit Hoxhajn, që edhe njëherë tund rrjetën e Partizanit, viktima e tij e preferuar në Superligë, duke bërë të shpërthejë në feste e gjithë pankina vlonjate. Sikur të mos mjaftonte goli, Juliano humbet Adorjan për arsye dëmtimi dhe në minutën e 27-të hedh në fushën e lojës Herrerenë. Par-

SUPERLIGA		
JAVA E 8-të		
TË SHTUNËN		
Lushnja - Teuta	2-1	
Skënderbeu - Luftëtari	2-0	
TË DIELËN		
Kukësi - Vllaznia	2-2	
Partizani - Flamurtari	0-1	
TË HËNËN		
Kamza - Laçi	14:00	



tizani kërkon të reagojë në këtë fraksion loje, por gjuajtja e Trashit në minutën e 38-të është shumë pak arritur barazimin. Juliano përpigjet të ndryshojë diçka

në pjesën e dytë duke larguar La Kamerën për Jurgen Bardhin. Partizani fiton më shumë thellësi, ndërsa në minutën e 49-të ka dy momente të mira. Fillimisht

me Herrerenë që tenton akrobacinë, por ndalet nga Nurkovicin nga goditja e dënimit, por gardiani i Kosovës kontrollon situatën. Në të 70-ën është Kalarë që provon sërish nga goditja standarde, por topi del pak mbi tra. Partizani nuk ka kthjellësinë e as fantazinë e duhur për të çarë murin vlonjat, ndërsa edhe Malota me kokë në të 90-ën vetëm sa i afrohet golit pa arritur të gjejë rrjetën. Partizani mbetet në vendin e katërt me 11 pikë, ndërsa tani duhet të fillojë të mendojë sesi të ruajë këtë pozicion, pasi gara me pjesën e sipërme të tabelës duket e humbur që në start. Nga ana tjetër, Flamurtari së bashku me Kukësin janë në duel direkt për të qenë antagolistët e Skënderbeut.

TRAJNERI VLLAZNISË



Gjoka: Gjici? Jam i lumtur për barazimin

Trajneri i Vllaznisë, Ernest Gjoka, pranon se njohja e mirë e lojtarëve të Kukësit e ndihmoi për ta përgatitur këtë ndeshje. Në deklaratën e dhënë për "Super-sport", ai nuk pranoi të replikonte me Gjicin duke i dhënë meritat kryesore për suksesin e vjetshëm të Kukësi. "Ashtu siç e kishim përgatitur ndeshjen, ashtu erdhi. E goditëm kundërshtarin në befasi dy herë, por nuk ishim në atë moment psikologjik për ta mbajtur presionin, luanim ndaj një Kukësi kampion, por duhet të rritemi dhe të kemi besim te vetja. 5-6 lojtarë të Kukësit i njoh deri në thellësi se i kam stërvitur vetë një vit të tërë. Ua kisha shpjeguar lojtarëve futjen e Kale nga qendra dhe ky është i vetmi merak që më ka ngeluar. Kale mund të shënonte nga pozicioni tjetër por jo nga qendra, sepse kishim punuar shumë për të ndaluar diçka të tillë. Nuk kam dëshirë t'i kthejë përgjigje Gjicit. Kemi bërë një vit të jashtëzakonshëm të dy, ai ka meritën kryesore, sepse ka prodhuar dhe ndërtaur një skuadër shumë të mirë. Unë jam profesionist dhe duhet t'i lavdëroj dhe jo t'i ofendoj njerëzit."

TRAJNERI I FLAMURTARIT

Nuk doja të isha unë protagonist i humbjes së Flamurtarit, por unë jam profesionist. Jam i kënaqur për fitoren ndaj një skuadre që pretendon titullin dhe që vinte me moral të lartë pas tri fitoreve. E kisha bindur skuadrën se mund të fitonim në Tiranë përballë Partizanit, sepse ata (të kuqtë) asnjëherë nuk kanë bindur me futboll cilësor. Ishte një fitore shumë e rëndësishme kundër një rivali të rrezikshëm. Fakti që unë e njoh Partizanin? Po injoh me detaje "demat" dhe gjithë ndeshjen sot e kishim fokusuar në Trashit. U përqopëm që të neutralizim lojtarin e tyre më të mirë dhe mendoj se ia ar-



ritëm qëllimit. La bëra të qartë skuadrës së duhet të përqendroheshin te Trashit dhe Prognin në të djathtë. Por lojtarët e bënë mirë detyrën. Sulmi? Kemi shënuar gjithnjë. Kemi një ekuilibër të mirë në ekip dhe kjo është shumë pozitive. Sa i përket autorit të golit, po ju them se Ardit Hoxhaj është

të pjesë e skuadrës dhe ka vlera të mëdha. Gjithsesi unë kam një grup të mirë dhe ai është pjesë e një grupi të rëndësishëm. E justifikoi plotësisht besimin tim, sepse luajti mirë edhe përballë Prognit dhe Trashit. A jemi në pretendentë? Tensionin më të madh e kam pasur sezonin e kaluar, sepse ishim për mbijetesë. Tani kanë ndryshuar gjërat dhe mendoj se do të ecim mirë. Falë edhe mbështetjes së Idrizit besoj se do të ecim mirë. Mumentalisht nuk kemi objektiv, por të shohim, sepse oreksi vjen duke ngrënë...". -ta Duro në përfundim të takimit.


TRAJNERI BESON ENDE

Juliano: U ndëshkuam nga një gjuajtje e vetme

Juliano është i bindur se skuadra e tij ka luajtur mirë kundër Flamurtarit, pavarësisht se humbi në shtëpi. I pyetur pas ndeshjes ai deklaroi për News24. "Na vjen keq, sepse u ndëshkuam në gjuajtjen e vetme në portë. U përqopëm të merrnim fitoren në këtë ndeshje, por nuk gjëmëm dot rrugën e rrjetës. Jam i kënaqur me atë çka shfaqëm në fushën e lojës. Ekipi u paraqiti mirë dhe pavarësisht humbjes nuk mendoj se kemi bërë hapa prapa? A është ky pozicioni që meriton Partizani në tabelë? Jo nuk mund ta them këtë. Kampionati është ende i gjatë dhe ne kemi lënë shumë pikë dhe duhet të rikuperojmë sa të mundemi".



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Janë rivalë.
12. Kurosawa, regjisori i Rashomon
14. Janë fushat sportive.
15. Memoria në computer
16. Inicialet e Konicës.
18. Halili këngëtare
19. I famshmi Pacino.
20. Ishin kalorësit e Karlit të Madh
23. Fundet pa fund.
24. Eshhtë shenjë goditjesh.
26. Giberna në MotoGP.
28. Janë kulla në xhami.
29. Ente Tregtare Durrës.
30. Janë temperaturat më të ulëta.
31. Christian i modës
33. Pak anakronike.
41. Erwin që thirrej Dhepra e shkretëtirës.
46. Eshhtë garë sipërmarrësish.
39. Në fillim të verës
42. Diego pa çifte.
40. Të fundit në tender.

43. Mund të jenë kuzhine.
45. Mbyllin një krah
46. Merret nga ai që çan ferrën.
49. Kufij itinerari.
50. Një... italiane.
51. Një treshe në skenë.
52. Ka ndodhur.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
2. Basinger aktore.
3. Mbetur në fund.
4. Fillojnë nazet.
5. Të parat në stadium.
6. Parashitesë për gjysmë.
7. Një mund të jetë ekspres
8. Janë ndalime në pranga.
9. Marina këngëtare italiane.

10. Mund të jetë autonome.
11. Një sallë për drama.
13. Eshhtë laps.
16. Eshhtë bota e luleve
17. Trëndafil i Japonisë.
20. Një bukë që hahej me qofte.
21. Janë kapo kozakë.
22. Ndryshon një çdo ditë.
25. Punon në galeri.
27. Emri tjetër i Esaut.
29. Emri i dikurshëm i Tokyo-s
30. Një mund të jetë arkëtimi.
32. Një vrap pele.
34. Kujtohet në nostalgji në pleqëri.
35. Franz kompozitor
41. Qerre pa qe.
44. Ente Industriale Rajonale.
47. Qendër në kaos.
48. Inicialet e Gide.
50. Diftong në duar.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. U shpik nga Volta.
5. Janë si kasolle
11. Negri ppete italiane.
12. Mund të jenë edhe plehrash.
14. Fillojnë raportin
15. Mbarojnë kurse
16. Emër djali.
17. Sharif aktor.
19. Ai dhe ajo.
21. U verbua nga Askush
24. Kanë mbetur në klasë.
26. Ishte djali tjetër i Odiseut.
27. Topat pa kufij.
29. Janë edhe ato ultraviolet.
30. Në krye të noterëve.
31. Një Baba përrallor.
32. Rrota pa ekstreme.
34. Mund të jetë diesel.

VERTIKAL


37. Ashtu qofë... o hoxhë!
38. Lidh computerin me telefonin një i tillë.
40. Një pjesë e gastritit.
41. Lumi i Bernës.
43. Janë pikat në statut.
44. Janë çift në gjethe.
46. Mc... shijeta e argjendte.
48. Pam aktore.
50. Thahen me bonifikime.
51. Paguhet një për vonesa

VERTIKAL


1. Ato biometrike nuk kanë nevojë për viza
2. Lindin në kokë
3. Nota e diapazonit
4. Janë të përpjeta.
5. Një këngëtar lirik.
6. Mbyllin një dyqan.
7. Mbarojnë fare
8. Eshhtë grimcë me bërthamë.
9. Eshhtë lloj papagalli.
10. Paguhet për shërbim.
12. Mund të jenë kasketa.
13. Personazh i njohur i Woody Allen.
18. Flet për Pegason dhe Belerofontit.
20. Eshhtë anë kryesore gjaku.
22. Eshhtë dukuria.
23. Besim pa kufij
25. Si stinore.
28. Mund të ishin bukanierë.
31. Mbyllin portat.
33. Claude-Oscar piktor.
35. Eshhtë shkronjë e rezistencës
36. Lumë në Francë.
39. Pak dendësi.
42. Rastet pa set
45. Fillojnë detyrën.
47. Rastisin në krye.
49. Inicialet e Magritte piktor.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

1	2						7
		8	1		2	4	
		9		4	7		2
			2	3			1
	6		5		8		4
9	5			7	6		
7	2		3	9		5	
		4	6		5	9	
8					3		1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	8	1	2	4	3	5	6	9
5	2	3	6	9	1	8	4	7
6	9	4	8	5	7	2	3	1
9	7	5	3	6	2	4	1	8
4	3	8	7	1	9	6	5	2
1	6	2	5	8	4	9	7	3
3	5	7	9	2	6	1	8	4
2	4	6	1	7	8	3	9	5
8	1	9	4	3	5	7	2	6



Argëtim filozofik

- Mos shkatërro atë që ke, duke dashur me epsh atë që nuk ke. Mbjaj mend se ajo që tani ke, dikur ishte gjëja e parë e atyre që dëshiroje të kishe". **Epikuri**
- "Miku i vërtetë është ai i cili duke të dhënë dorën, të prek zemrën". **Gabriel Garcia Marquez**
- "Mos ki frikë nëse përparon ngadalë. Kij frikë nëse do të qëndrosh në vend dhe nuk do të përparosh". **Konfuci**

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Ehënie të mençura

- Asgjë nuk e forcon autoritetin më shumë se heshtja.
- Kam vënë re se njerëzit trallë përpiqen të arrijnë diçka. Ata më tepër rehatohen dhe i lënë gjërat t'u ndodhin. Në fakt, ata i dolën përpara rastësisë dhe u ndodhën të gjërat.
- Arti nuk mbaron kurrë, vetëm braktiset.
- Irlandeze: Ji i lumtur me çfarë ke, do të shohësh se ke përse të jesh i lumtur.
- Sokrati: Lumturia është dhunti e natyrshme, mjerimin e shkaktojnë mungesat artificiale.
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

